



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.186

dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1039, datë 22.12.2010	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instalimeve kablore për transportin e njerëzve”..... 10323
Vendim i KM nr.1054, datë 22.12.2010	Për miratimin e rregullores “Për pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”..... 10341
Vendim i KM nr.1073, datë 3.11.2010	Për miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2011-2013, të rishikuar..... 10353
Vendim i KM nr.1074, datë 3.11.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.588, datë 28.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuadrit makroekonomik, të treguesve makroekonomikë e fiskalë të rishikuar dhe të taveve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2011-2013”..... 10353
Urdhër i MPPT nr.184, datë 20.12.2010	Për procedurën dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative në fushën e aviacionit civil”..... 10358

VENDIM
Nr.1039, datë 22.12.2010

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË INSTALIMEVE KABLORE PËR TRANSPORTIN E
NJERËZVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instalimeve kablore për transportin e njerëzve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 31 dhjetor 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULL TEKNIK
**PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË INSTALIMEVE
KABLORE PËR TRANSPORTIMIN E NJERËZVE**

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 Ky rregull teknik zbatohet për instalimet e teleferikëve të projektuar për të transportuar njerëz.

1.2 Për qëllime të këtij rregulli teknik, me “instalime të teleferikëve të projektuar për të transportuar njerëz” nënkuptojnë instalimet e përbëra nga disa komponentë, të projektuar, prodhuar, montuar dhe vënë në shërbim për të transportuar njerëz.

Këto instalime, të montuara në një vend të caktuar, përdoren për transportin e njerëzve në kabina ose nga pajisje që tërhiqen, ku qëndrimi pezull dhe/ose tërheqja e tyre realizohet nëpërmjet litarëve metalikë përgjatë linjës së lëvizjes.

1.3 Instalimet që përfshihen janë:

a) mjete hekurudhore funikulare dhe instalime të tjera me mjete transporti të montuara mbi rrota ose mbi pajisje të tjera të varura, ku tërheqja realizohet nga një ose më shumë litarë metalikë;

b) platformat ngritëse, ku kabinat ngrihen dhe/ose zhvendosen duke u tërhequr nga një ose më shumë litarë metalikë mbajtës; kjo kategori përfshin, gjithashtu, edhe gondolat dhe platformat ngritëse në formë karrijeje;

c) teleferikët me tërheqje, ku përdoruesit, me pajisje të përshtatshme, tërhiqen nëpërmjet një litari metalik.

1.4 Ky rregull teknik zbatohet për:

a) instalimet e ndërtuara dhe të vëna në punë;

b) nënsistemet dhe komponentët e sigurisë të vendosur në treg.

Rregulli teknik ka të bëjë me dispozitat e harmonizuara që nevojiten dhe janë të mjaftueshme për të siguruar dhe garantuar përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të referuara në pikën 1.8.

Në rastin kur karakteristika të rëndësishme, nënsisteme ose komponentë të sigurisë të instalimeve ekzistuese u nënshtrohen ndryshimeve, për të cilat kërkohet një autorizim i ri për vënien në punë, këto modifikime dhe efektet e tyre në tërësinë e instalimit duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore që janë të referuara në pikën 1.8.

1.5 Për qëllime të këtij rregulli teknik:

a) “Instalim” nënkupton një sistem të tërë të montuar në vend të caktuar, që përbëhet nga infrastruktura dhe nënsistemet që janë të listuara në pikën 11, dhe ku infrastruktura e projektuar enkas për çdo instalim dhe e ndërtuar në vendndodhje nënkupton shtrirjen e saj, të dhënat e sistemit, strukturat

në vendet e ndalimit dhe strukturat përgjatë linjës, duke përfshirë këtu dhe bazamentet, të cilat janë të nevojshme për ndërtimin dhe përdorimin e instalimit.

b) “Komponent i sigurisë” nënkupton çdo komponent bazë, grup komponentësh, montime pjesore ose montime të plota të pajisjes dhe të çdo pajisjeje që përfshihet në instalim, me qëllim që të garantojë një funksion sigurie të identifikuar nëpërmjet analizës së sigurisë, mosfunksionimi i së cilës rrezikon sigurinë ose shëndetin e njerëzve që mund të jenë përdorues, personel i shërbimit ose palë të treta.

c) “Kontraktor kryesor” nënkupton çdo individ, person fizik ose juridik që porosit ndërtimin e një instalimi.

d) “Funksionim” nënkupton të gjitha parashikimet dhe masat teknike, të cilat ndikojnë mbi projektimin dhe realizimin e një instalimi dhe janë të nevojshme që instalimi të funksionojë në mënyrë të sigurt.

e) “Mirëmbajtje” nënkupton të gjitha parashikimet dispozitat dhe masat teknike, të cilat kanë një ndikim mbi projektimin dhe realizimin dhe janë të nevojshme që mirëmbajtja e projektuar të sigurojë se instalimi funksionon në mënyrë të sigurt.

f) “Organizëm europian” nënkupton çdo organizëm të regjistruar europian, përgjegjës për kryerjen e një procedure të vlerësimit të konformitetit të referuar në pikat 2.4 dhe 3.4. Numri i identifikimit, fusha e kompetencës dhe lista e tyre është botuar në Fletoren Zyrtare të KE-së.

1.6 Ky rregull teknik nuk zbatohet:

a) për ashensorët brenda kuptimit të rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit për ashensorët”;

b) për tramvajet tradicionale që funksionojnë me litarë metalikë;

c) për instalimet e përdorura për qëllime bujqësore;

d) për pajisje stacionare ose të lëvizshme që përdoren në panairë dhe/ose parqe lodrash, të cilat janë projektuar për qëllime argëtimi dhe jo si mjete për transportin e njerëzve;

e) për instalimet në miniera ose instalimet stacionare për qëllime industriale;

f) për anije-trap që funksionojnë me litarë metalikë;

g) për hekurudha të tipit me kremalierë;

h) për instalime që vihen në lëvizje me zinxhirë.

1.7 Ky rregull teknik zbatohet pa cenuar rregulla të tjerë teknikë, edhe nëse përputhshmëria me kërkesat thelbësore të përcaktuara në këtë rregull teknik mund të kërkojë zbatimin e specifikimeve të tjera të veçanta të përcaktuara për këtë qëllim.

1.8 Instalimet dhe infrastruktura e tyre, nënsistemet dhe komponentët e sigurisë së një instalimi duhet të përputhen me kërkesat thelbësore të përshkruara në pikën 12 dhe janë të zbatueshme për to.

1.9 Kur një standard i harmonizuar shqiptar, referimi i të cilit është publikuar në Fletoren Zyrtare, mbulon kërkesat thelbësore mbi sigurinë, që janë të përcaktuara në pikën 12, instalimet dhe infrastruktura e tyre, nënsistemet dhe komponentët e sigurisë të çdo instalimi, të ndërtuar në përputhje me standardin në fjalë, prezumohen se përmbushin kërkesat përkatëse thelbësore.

1.10 Me kërkesë të kontraktorit kryesor ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar, të gjitha instalimet e planifikuara duhet të jenë objekt i një analize mbi sigurinë, siç është përcaktuar në pikën 10, e cila përfshin të gjitha aspektet e sigurisë së sistemit dhe të mjedisit të tij rrethues në kuptimin e projektimit, realizimit dhe vënies në punë dhe, që mbështetur në eksperiencën e mëparshme, mundëson identifikimin e risqeve që mund të ndodhin gjatë përdorimit.

1.11 Analiza mbi sigurinë duhet të jetë objekt i një raporti mbi sigurinë, që rekomandon masat e nevojshme në raste të një risku të tillë, duke përfshirë edhe një listë të komponentëve të sigurisë dhe të nënsistemeve, që përshkruhen në pikën 2 ose 3 sipas rastit konkret.

2. Komponentët e sigurisë

2.1 Strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportit marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se komponentët e sigurisë:

a) vendosen në treg vetëm nëse ato mundësojnë që konstruksioni i instalimeve është në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikën 1.8;

b) vendosen në shërbim vetëm nëse ato mundësojnë që konstruksioni i instalimeve nuk rrezikon shëndetin ose sigurinë e njerëzve, ose sipas rastit, sigurinë e pronës, kur instalohen e mirëmbahen në mënyrën e duhur dhe përdoren plotësisht sipas qëllimit të tyre të parashikuar.

2.2 Nuk pengohet, kufizohet ose ndalohet vendosja në treg e komponentëve të sigurisë që janë parashikuar të përdoren në një instalim kur këta komponentë janë në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik.

2.3 Komponentët e sigurisë, të referuar në pikën 1.11, që kanë markimin CE të konformitetit të përshkruar në pikën 16 dhe që shoqërohen me deklaratën EC të konformitetit të përshkruar në pikën 11, konsiderohen se janë në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse të këtij rregulli teknik.

2.4 Përpara se një komponent i sigurisë të vendoset në treg, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar:

a) duhet të paraqesë për shqyrtim komponentin e sigurisë në një procedurë të vlerësimit të konformitetit në përputhje me pikën 12; dhe

b) duhet të vendosë markimin CE të konformitetit mbi komponentin e sigurisë dhe, mbi bazën e moduleve që janë përcaktuar në pikën 12, të hartojë një deklaratë EC të konformitetit në përputhje me pikën 11.

2.5 Procedura për vlerësimin e konformitetit të komponentit të sigurisë do të kryhet me kërkesë të fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar nga një organ i autorizuar/organizëm europian dhe i zgjedhur për këtë qëllim nga vetë ai.

2.6 Kur komponentët e sigurisë janë objekt edhe i rregullave të tjerë teknikë, në lidhje me aspekte të tjera, dhe që parashikojnë vendosjen e markimit CE të konformitetit, markimi do të tregojë se komponentët e sigurisë prezumohen në përputhje me dispozitat e këtyre rregullave teknikë.

2.7 Kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk plotëson detyrimet e pikave nga 2.3 deri në 2.6, çdo person që vendos komponentin e sigurisë në treg është përgjegjës për plotësimin e këtyre detyrimeve, përfshirë blerësin apo importuesin. Të njëjtat detyrime zbatohen dhe për këdo që prodhon komponentët e sigurisë për përdorim vetjak.

3. Nën sistemet

3.1 Strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se nën sistemet, brenda kuptimit të pikës 8, vendosen në treg vetëm nëse ato mundësojnë ndërtimin e instalimeve duke përmbushur kërkesat thelbësore sipas pikës 1.8.

3.2 Nuk pengohet, kufizohet ose ndalohet vendosja në treg e nën sistemeve që janë të parashikuara të përdoren në një instalim, kur ato janë në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik.

3.3 Nën sistemet, brenda kuptimit të pikës 8, të cilët janë të shoqëruar nga deklaratat EC e konformitetit sipas modelit të përcaktuar në pikën 13 dhe nga dokumentacioni teknik i përcaktuar në pikën 3.5, konsiderohen në përputhje me kërkesat përkatëse thelbësore sipas pikës 1.8.

3.4 Procedura për shqyrtimin EC të nën sistemeve kryhet me kërkesë të fabrikuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar, ose në mungesë të tyre, të çdo personi fizik ose juridik, i cili vendos në treg nën sistemin në fjalë, nga organi i autorizuar/organizëm europian, të cilin fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose personi i përshkruar më sipër e zgjedh për këtë qëllim.

Deklarata EC e konformitetit hartohet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, ose personi i përmendur më sipër mbi bazën e shqyrtimit EC në përputhje me pikën 14.

3.5 Organi i autorizuar/organizmi europian harton certifikatën e shqyrtimit EC në përputhje me pikën 14, si dhe dokumentacionin teknik që e shoqëron atë.

Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë të gjitha dokumentet e nevojshme lidhur me karakteristikat e nën sistemit dhe, ku kërkohet, të gjitha dokumentet e duhura që garantojnë konformitetin e komponentëve të sigurisë.

Dokumentacioni teknik përmban, gjithashtu, të gjitha hollësitë që lidhen me kushtet dhe kufizimet mbi përdorimin, si dhe udhëzimet e shërbimit.

4. Instalimet

4.1 Ministri përgjegjës për transportin ngre një komision për dhënien e autorizimit për ndërtimin dhe vënien në shërbim të instalimeve, të cilat vendosen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Komisioni për dhënien e autorizimit, i ngritur nga ministri përgjegjës për transportin, merr të gjitha masat e duhura që të garantojë se komponentët e sigurisë dhe nën sistemet e referuara në pikën 8, të inkorporuara në instalimet e ndërtuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë montuar dhe vënë në shërbim vetëm nëse ato garantojnë ndërtimin e instalimeve që nuk rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e njerëzve ose, ku kërkohet, sigurinë e pronës, kur instalohen dhe mirëmbahen në mënyrën e duhur dhe përdoren në përputhje me qëllimin e tyre të parashikuar.

4.3 Kur Komisioni për dhënien e autorizimit, i ngritur nga ministri përgjegjës për transportin konsideron se një komponent i sigurisë ose një nënsistem i referuar në pikën 8 është projektuar ose ndërtuar duke përdorur një metodë të re, ai merr të gjitha masat përkatëse dhe mund të kërkojë që ndërtimi dhe/ose vendosja në shërbim i një instalimi me komponentë ose nënsisteme të tilla, të jetë objekt i kushteve të veçanta. Këta komponentë të sigurisë apo nënsisteme duhet të përmbushin kërkesat thelbësore përkatëse të sigurisë të këtij rregulli teknik dhe do të jenë subjekt i procedurave të vlerësimit të konformitetit në përputhje me pikat 2.4 dhe 3.4 të këtij rregulli teknik.

4.4 Komisioni për dhënien e autorizimit, i ngritur nga ministri përgjegjës për transportin, merr të gjitha masat që të sigurojë se instalimet janë ndërtuar dhe vënë në shërbim vetëm nëse ato janë projektuar dhe ndërtuar, në mënyrë që të garantojnë përputhjen me kërkesat thelbësore që janë të referuara në pikën 1.8. Kontrolli përfundimtar i instalimit ka për qëllim garantimin e shëndetit dhe sigurisë së njerëzve dhe pronës. Ky kontroll përfshin aspektet në lidhje me infrastrukturën, ndërveprimet ndërmjet nënsistemeve, ndërveprimet ndërmjet nënsistemeve dhe infrastrukturës, faktorët specifikë të projektit lidhur me vendin e instalimit, mjedisin, përputhshmërinë e certifikatave dhe deklaratave të konformitetit për të gjithë komponentët e sigurisë dhe nënsistemeve, si dhe të analizave të sigurisë.

4.5 Mbështetur në dispozitat e referuara në pikën 4.1, nuk ndalohet, kufizohet ose pengohet lëvizja e lirë e komponentëve të sigurisë dhe e nënsistemeve të referuara në pikën 8, të cilët janë të shoqëruar me një deklaratë EC të konformitetit brenda kuptimit të pikave nga 2.3 deri te 2.7 ose të pikave nga 3.3 deri te 3.5.

4.6 Në mënyrë që të marrë aprovimin e instalimit, kontraktori kryesor ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të paraqesë pranë komisionit për dhënien e autorizimit, të ngritur nga ministri përgjegjës për transportin, analizën mbi sigurinë, deklaratat EC të konformitetit dhe dokumentacionin teknik shoqërues për komponentët e sigurisë dhe nënsistemet e referuara sipas pikës 8 dhe një kopje e tyre do të mbahet në vendndodhjen e instalimit.

4.7 Komisioni për dhënien e autorizimit, i ngritur nga ministri përgjegjës për transportin, duhet të sigurojë se janë dorëzuar analizat e sigurisë, raporti mbi sigurinë dhe dokumentacioni teknik, duke përfshirë të gjithë dokumentacionin me të dhënat që kanë të bëjnë me karakteristikat e instalimit dhe, ku kërkohet, të gjitha dokumentet që certifikojnë konformitetin e komponentëve të sigurisë dhe të nënsistemeve sipas pikës 8.

Raporti mbi sigurinë përcakton masat për eliminimin e risqeve të dala nga analizat e sigurisë.

Raporti mbi sigurinë nuk hartohet nga persona, të cilët kanë marrë pjesë në hartimin e analizave të sigurisë.

Përveç kësaj, dokumentet duhet të pasqyrojnë kushtet e nevojshme të përdorimit, duke përfshirë kufizimet e përdorimit, si dhe të gjitha detajet e mbikëqyrjes së shërbimit, riparimit dhe mirëmbajtjes.

4.8 Pa kundërshtuar dispozita të tjera ligjore, nuk ndalohet, kufizohet ose pengohet ndërtimi dhe vënia në shërbim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të instalimeve, të cilat janë në përputhje me këtë rregull teknik.

4.9 Strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportit monitorojnë për të siguruar se një instalim vazhdon të jetë në përdorim vetëm nëse ai është në përputhje me kushtet e dhëna në raportin e sigurisë.

5. Mbikëqyrja e sigurisë

5.1. Kur strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportit sigurohen se një komponent i sigurisë, që mban markimin CE të konformitetit, i vendosur në treg dhe i përdorur në përputhje me qëllimin e tij të parashikuar, ose kur një nënsistem që ka një deklaratë EC të konformitetit, siç referohet në pikën 3.3, dhe i përdorur në përputhje me qëllimin e tij të parashikuar, mund të rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, dhe sipas rastit, sigurinë e pronës, ajo ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar kushtet e përdorimit të komponentit të sigurisë ose të nënsistemit, ose ndalon përdorimin e tij.

Strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportin njoftojnë menjëherë këtë ministri për çdo masë të marrë duke treguar arsyet mbi vendimin e marrë dhe nëse mospërputhshmëria veçanërisht është për shkak:

- a) të mosplotësimit të kërkesave thelbësore të referuara në pikën 4.4;
- b) të zbatimit jo të saktë të standardeve të harmonizuara shqiptare kur zbatimi i këtyre standardeve është i përfshirë;
- c) mungesa në standardet e harmonizuara shqiptare.

5.2 Ministria që mbulon fushën e transportit hyn në konsultime me palët e përfshira.

Kur pas konsultimeve të tilla gjendet se:

a) masat në lidhje me një komponent të sigurisë janë të pajustificuara, ajo informon menjëherë fabrikuesin ose përfaqësuesin e tij të autorizuar dhe strukturën përgjegjëse, e cila morri masat;

b) masat në lidhje me një nënsistem janë të pajustificuara, ajo informon menjëherë fabrikuesin ose përfaqësuesin e tij të autorizuar, ose në mungesë të tyre personin fizik ose juridik që ka vendosur në treg sistemin në fjalë dhe strukturën përgjegjëse, e cila mori masat.

5.3 Kur një komponent i sigurisë që ka të vendosur markimin CE gjendet jo në përputhje, strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportit, ndërmarrin veprimin përkatës kundrejt atij që ka vendosur markimin dhe ka hartuar deklaratën e konformitetit dhe informon menjëherë ministrinë që mbulon fushën e transportit.

5.4 Kur një nënsistem me një deklaratë të konformitetit gjendet jo në përputhje, strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportit ndërmarrin veprimin përkatës përkundrejt atij që ka hartuar deklaratën e konformitetit dhe informon menjëherë ministrinë që mbulon fushën e transportit.

5.5 Nëse strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportit konstatojnë se një instalim i aprovuar, i cili përdoret në qëllimin e tij të parashikuar mund të rrezikojë sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, dhe sipas rastit, sigurinë e pronës, ajo ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar kushtet e përdorimit të instalimit ose të ndalojë përdorimin e tij.

6. Markimi CE i konformitetit

6.1 Markimi CE i konformitetit përbëhet nga germat “CE”. Pika 16 përcakton modelin që duhet përdorur.

6.2 Markimi CE i konformitetit vendoset në çdo komponent të sigurisë në mënyrë të qartë dhe të dukshme ose, kur nuk ka mundësi, mbi një etiketë që vendoset në mënyrë të paheqshme në komponent.

6.3 Ndalohet vendosja mbi komponentin e sigurisë e markimeve, të cilat mund të çorientojnë palët e treta, si në kuptimin ashtu dhe në formën e markimit CE të konformitetit. Çdo markim tjetër mund të vendoset te komponenti i sigurisë, me kusht që të mos ulet dukshmëria dhe lexueshmëria e markimit CE të konformitetit.

6.4 Pa paragjykuar pikën 5:

a) Atje ku strukturat përgjegjëse në varësi të ministrit që mbulon fushën e transportit konstatojnë se markimi CE i konformitetit është vendosur në mënyrë të parregullt, fabrikuesi i komponentit të sigurisë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar është i detyruar të sjellë produktin në përputhje me dispozitat që lidhen me kërkesat e markimit CE të konformitetit dhe të eliminojë shkeljen sipas kushteve të vëna.

b) Kur mospërputhja vazhdon, ajo duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar ose ndaluar vendosjen në treg të komponentit të sigurisë në fjalë, ose të sigurojë heqjen e tij nga tregu në përputhje me procedurat e dhëna në pikën 5, si dhe informon ministrinë që mbulon fushën e transportit.

7. Dispozita përfundimtare

7.1 Çdo vendim që merret në zbatim të këtij rregulli teknik, i cili kufizon përdorimin e komponentit të sigurisë ose të një nënsistemi në një instalim, ose vendosjen e tyre në treg, duhet të japë arsytet mbi të cilat mbështetet.

Një vendim i tillë i njoftohet palës së interesuar në mundësinë më të parë, e cila në të njëjtën kohë informohet mbi mundësinë e rregullimeve të disponueshme për të nga ligji në fuqi, si dhe të afateve kohore brenda të cilave janë subjekt këto masa rregulluese/korrigjuese.

7.2 Instalimet për të cilat autorizimi është dhënë përpara hyrjes në fuqi të këtij rregulli teknik dhe ndërtimi i tij nuk ka filluar akoma duhet të plotësojë dispozitat e këtij rregulli teknik.

8. Nënsistemet e një instalimi

Për qëllime të këtij rregulli teknik dhe duke marrë parasysh në çdo rast shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit, një instalim ndahet në infrastrukturën e tij dhe në nënsistemet e listuara më poshtë:

a) Litarët metalikë dhe bashkimet e tyre;

b) Motorët dhe frenat;

c) Pajisjet mekanike:

i) mekanizmi i tërheqjes së litarëve metalikë;

ii) agregati;

- iii) inxhinieria e linjës;
- d) Mjetet transportuese:
 - i) kabinat, ndenjëset ose pajisjet tërheqëse;
 - ii) mekanizmi i qëndrimit varur;
 - iii) mekanizmi i lëvizjes;
 - iv) bashkimet me litarët metalikë;
- e) Pajisjet elektroteknike:
 - i) pajisjet e monitorimit, të kontrollit dhe të sigurisë;
 - ii) pajisjet e komunikimit dhe të informimit;
 - iii) pajisjet mbrojtëse nga vetëtimat;
- f) Pajisjet e shpëtimit:
 - i) pajisjet e palëvizshme të shpëtimit;
 - ii) pajisjet e lëvizshme të shpëtimit.

9. Kërkesa thelbësore

9.1 Qëllimi

Kjo dispozitë përcakton kërkesat thelbësore, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe funksionimin, të zbatueshme për projektimin, ndërtimin dhe vënien në shërbim të instalimeve të referuara në pikën 1.5 të këtij rregulli teknik.

9.2 Kërkesa të përgjithshme

9.2.1 Siguria e njerëzve

Siguria e përdoruesve, e punonjësve të shërbimit dhe e personave të tjerë është kërkesa themelore për projektimin, ndërtimin dhe funksionimin e instalimeve.

9.2.2 Parimet e sigurisë

Të gjitha instalimet duhet të projektohen, të përdoren dhe të mirëmbahen në përputhje me parimet e mëposhtme, të cilat duhet të zbatohen sipas kësaj renditjeje:

- a) të eliminohen ose, nëse kjo nuk është e mundur, të zvogëlohen risqet nëpërmjet veçorive karakteristike të ndërtimit dhe projektimit;
- b) të përcaktohen dhe të zbatohen të gjitha masat e nevojshme për t'u mbrojtur nga risqe, të cilat nuk mund të eliminohen nga veçoritë karakteristike të ndërtimit dhe projektimit;
- c) të përcaktohen dhe të vendosen masat paraprake, të cilat duhet të ndërmerren për të shmangur risqe, të cilat nuk ka qenë e mundur të eliminohen plotësisht me anën e dispozitave dhe masave të referuara në paragrafin a) dhe b) të kësaj dispozite.

9.2.3 Konsiderimi i faktorëve të jashtëm

Instalimet duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që të mundësojnë përdorimin e sigurt të tyre, duke marrë parasysh tipin e instalimit, natyrën dhe veçoritë fizike të terrenit mbi të cilin ai është montuar, mjedisin rrethues dhe faktorët atmosferikë e meteorologjikë, si edhe strukturat e pengesat e mundshme që ndodhen në afërsi, në tokë ose në ajër.

9.2.4 Përmasat

Instalimi, nënsistemet dhe të gjithë komponentët e tij të sigurisë duhet të përmasohen, projektohen dhe ndërtohen që të përballojnë, me një koeficient të mjaftueshëm të sigurisë, të gjitha ngarkesat e ndeshura nën të gjitha kushtet e parashikuara, duke përfshirë edhe ato, të cilat veprojnë kur ai nuk është në funksionim, si dhe duhet të marrin parasysh në mënyrë të veçantë ndikimet e jashtme, efektet dinamike dhe fenomenin e lodhjes, ndërsa zbatohen normat e pranura teknike, veçanërisht në lidhje me zgjedhjen e materialeve.

9.2.5 Montimi

9.2.5.1 Instalimi, nënsistemet dhe të gjithë komponentët e sigurisë duhet të projektohen dhe të ndërtohen në mënyrë të tillë që të sigurohet në mënyrë të sigurt montimi dhe vendosja e tyre në vend.

9.2.5.2 Komponentët e sigurisë duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të bëjnë të pamundur gabimet gjatë montimit, qoftë për shkak të konstruksionit të tyre ose me ndihmën e shënimeve përkatëse mbi vetë komponentët e sigurisë.

9.2.6 Tërësia e instalimit

9.2.6.1 Komponentët e sigurisë duhet të projektohen e të ndërtohen dhe të jenë të përdorshëm në mënyrë të tillë që, në çdo rast, të sigurojnë tërësinë e tyre funksionale dhe/ose të garantohej siguria e instalimit, siç është përcaktuar në analizën e sigurisë të dhënë në pikën 10, kështu që mosfunksionimi i tyre të jetë krejtësisht i pamundur dhe të kenë një rezervë të mjaftueshme të sigurisë.

9.2.6.2 Instalimi duhet të projektohet dhe të ndërtohet në atë mënyrë që të sigurojë që, gjatë funksionimit të tij, çdo dëmtim i një komponenti, i cili mund të ndikojë mbi sigurinë, edhe në mënyrë të tërthortë, të plotësohet nga një masë e përshtatshme e marrë në kohën e duhur.

9.2.6.3 Masat e sigurisë të referuara në pikat 9.2.6.1 dhe 9.2.6.2 duhet të zbatohen gjatë gjithë periudhës ndërmjet dy inspektimeve të planifikuara të komponentit në fjalë.

Periudha kohore e inspektimit të planifikuar për komponentët e sigurisë duhet të tregohet qartë në manualin e përdorimit.

9.2.6.4 Komponentët e sigurisë, të cilët janë të përfshirë në instalime si pjesë këmbimi, duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik dhe kushtet në lidhje me ndërveprimin e mirë me pjesët e tjera të instalimeve.

9.2.6.5 Duhet të merren masa për të siguruar se efektet e një zjarri në instalim nuk rrezikojnë sigurinë e njerëzve që transportohen dhe të punonjësve të shërbimit.

9.2.6.6 Masa të veçanta duhet të merren për të mbrojtur instalimet dhe njerëzit nga efektet e vetëtimave.

9.2.7 Pajisjet e sigurisë

9.2.7.1 Çdo defekt në instalim që mund të çojë në një mosfunksionim që rrezikon sigurinë, aty ku është e mundur, duhet të zbulohet, të raportohet dhe të vepohet nëpërmjet një pajisjeje sigurie. E njëjta gjë zbatohet për çdo rast të jashtëm normalisht të parashikuar, që mund të rrezikojë sigurinë.

9.2.7.2 Duhet të jetë e mundur që në çdo kohë instalimi të ndalohej në mënyrë manuale.

9.2.7.3 Pasi instalimi të jetë ndaluar nga një pajisje sigurie, nuk duhet të jetë e mundur që ai të riniset pa ndërmarrë veprimet e duhura.

9.2.8 Mirëmbajtja

Instalimi duhet të projektohet dhe të ndërtohet, në mënyrë të tillë që të mundësojë në mënyrë të sigurt mirëmbajtjen e zakonshme ose të veçantë, si dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe procedurave riparuese.

9.2.9 Efekte të dëmshme

Instalimi duhet të projektohet dhe të ndërtohet, në mënyrë që të sigurojë se çdo efekt i dëmshëm, i brendshëm ose i jashtëm, që vjen nga gaze të dëmshme, emetime zhurmash ose vibrimesh, të jetë brenda kufijve të përcaktuar.

9.3 Kërkesa lidhur me infrastrukturën

9.3.1 Shtrirja, shpejtësia, distanca ndërmjet kabinave.

9.3.1.1 Instalimi duhet të projektohet që të funksionojë në mënyrë të sigurt, duke marrë parasysh karakteristikat e terrenit dhe mjedisin e tij rrethues, kushtet atmosferike dhe meteorologjike, ndonjë strukturë dhe pengesë të mundshme që gjendet në afërsi, në tokë apo në ajër, në atë mënyrë që të mos shkaktojë efekte të dëmshme ose të mos paraqesë rrezik nën kushtet e funksionimit ose shërbimit, ose në rast veprimi për të shpëtuar njerëz.

9.3.1.2 Duhet të sigurohet një distancë e mjaftueshme anash dhe vertikalisht ndërmjet kabinave, pajisjeve ngritëse, tërheqëse, litarëve metalikë etj., dhe strukturave e pengesave të mundshme, të ndodhura në afërsi, në tokë apo në ajër, duke marrë parasysh lëvizjet vertikale, gjatësore dhe anësore të litarëve metalikë dhe të kabinave ose mjeteve tërheqëse nën kushtet më të pafavorshme të parashikuara të punës.

9.3.1.3 Distanca maksimale ndërmjet kabinave dhe tokës duhet të marrë parasysh llojin e instalimit, tipin e kabinave dhe procedurat e shpëtimit. Në rastin e kabinave të hapura duhet marrë parasysh si risku i rënies, ashtu dhe aspektet psikologjike që lidhen me distancën ndërmjet kabinave dhe tokës.

9.3.1.4 Shpejtësia maksimale e kabinave ose pajisjeve tërheqëse, distanca minimale ndërmjet tyre dhe karakteristikat e përshpejtimit dhe frenimit duhet të zgjidhen që të garantojnë sigurinë e njerëzve dhe funksionimin e sigurt të instalimit.

9.3.2 Stacionet dhe strukturat përgjatë linjës

9.3.2.1 Stacionet dhe strukturat përgjatë linjës duhet të projektohen, të instalohen dhe të pajisen për të siguruar qëndrueshmëri.

Ato duhet të lejojnë udhëzim të sigurt të litarëve metalikë, kabinave dhe pajisjeve tërheqëse, dhe të mundësojnë që mirëmbajtja të kryhet e sigurt, nën të gjitha kushtet e operimit.

9.3.2.2 Hapësirat për hyrje dhe dalje në instalim duhet të projektohen që të garantojnë sigurinë e lëvizjes së kabinave, të pajisjeve tërheqëse dhe të njerëzve.

Lëvizja e kabinave dhe pajisjeve tërheqëse në stacione duhet të mundësojë transportin pa risk të njerëzve, duke marrë parasysh bashkëpunimin e mundshëm aktiv të tyre gjatë lëvizjes.

9.4. Kërkesa që lidhen me litarët metalikë, motorët dhe frenat, si dhe me instalimet mekanike e elektrike

9.4.1 Litarët metalikë dhe mbështetëset e tyre

9.4.1.1 Duhet të merren të gjitha masat në përputhje me arritjet më të fundit teknologjike:

- a) për të parandaluar këputjet e litarëve metalikë ose të bashkimeve të tyre;
- b) për të mbuluar vlerat minimale dhe maksimale të sforcimeve mekanike;
- c) për të siguruar që ato janë montuar në mënyrë të sigurt në mbështetëset e tyre dhe të parandalojnë daljen;
- d) për të mundësuar monitorimin e tyre.

9.4.1.2 Nuk është e mundur të parandalohen të gjitha risqet që vijnë nga dalja e litarëve metalikë, prandaj duhet të ndërmerren masa që të sigurojnë se, në rast të daljes së tyre, litarët metalikë të mund të rivendosen në vendet e tyre dhe instalimet të mund të ndalojnë pa shkaktuar rrezik për njerëzit.

9.4.2 Instalimet mekanike

9.4.2.1 Motorët

Sistemi motorik i një instalimi duhet të ketë një performancë dhe aftësi të përshtatshme për t'u përshtatur me regjime dhe mënyra të ndryshme shfrytëzimi.

9.4.2.2 Sistemi rezervë motorik

Instalimi duhet të ketë një sistem rezervë motorik për transmetimin e lëvizjes me një burim energjie të pavarur nga ai i sistemit kryesor. Sistemi rezervë nuk është i nevojshëm nëse analiza e sigurisë tregon se njerëzit mund të largohen nga kabinat dhe, veçanërisht, nga pajisjet tërheqëse lehtësisht, shpejt dhe të sigurt, madje edhe nëse sistemi rezervë nuk është i disponueshëm.

9.4.2.3 Frenimi

9.4.2.3.1 Në një rast emergjence, duhet të mundësohet ndalimi në çdo moment i instalimit dhe/ose kabinave, nën kushtet më të pafavorshme në lidhje me ngarkesën e lejuar dhe aderencën e litarit mbi pulexho gjatë operimit. Distanca e ndalimit duhet të jetë aq e shkurtër sa diktohet nga siguria e instalimit.

9.4.2.3.2 Vlerat e ngadalësimit duhet të jenë brenda kufijve të përshtatshëm, të përcaktuar në atë mënyrë që të garantojnë si sigurinë e njerëzve ashtu dhe funksionimin e mirë të kabinave, të litarëve metalikë dhe pjesëve të tjera të instalimit.

9.4.2.3.3 Në të gjitha instalimet duhet të jenë dy ose më shumë sisteme frenimi, secili i aftë të shkaktojë ndalimin e instalimit, dhe të jenë të koordinuar në mënyrë të tillë që ata automatikisht të zëvendësojnë sistemin aktiv kur efektshmëria e këtij të fundit bëhet e pamjaftueshme.

Sistemi i fundit i frenimit i litarit metalik duhet të veprojë direkt mbi pulexhon aktive. Këto dispozita nuk zbatohen në teleferikët me tërheqje.

9.4.2.3.4 Instalimi duhet të pajiset me një mekanizëm ndalimi dhe bllokimi që e mbron atë nga rinisjet e parakohshme.

9.4.3 Pajisjet e kontrollit

Pajisjet e kontrollit duhet të projektohen dhe të konstruktohen në mënyrë që të jenë të sigurta dhe të besueshme për t'u rezistuar ngarkesave normale të punës, ashtu dhe faktorëve të jashtëm, si: lagështia, temperaturat e tejskajshme apo interferencat elektromagnetike, si dhe që të mos shkaktojnë situata të rrezikshme, madje as në rastin e një gabimi gjatë operimit.

9.4.4 Pajisjet e komunikimit

Lehtësi të përshtatshme duhet të parashikohen për t'i dhënë mundësi stafit të shërbimit të komunikojë me njëri-tjetrin në çdo kohë dhe të informojë përdoruesit në rast emergjence.

9.5. Kabinat dhe mjetet tërheqëse

9.5.1 Kabinat dhe/ose mjetet tërheqëse duhet të projektohen dhe pajisen në atë mënyrë që nën kushte të parashikuara të punës asnjë person të mos bjerë jashtë ose të ndeshë ndonjë rrezik tjetër.

9.5.2 Pajisjet e kabinave dhe pajisjeve tërheqëse duhet të përmasohen dhe të ndërtohen në mënyrë të tillë që:

- a) të mos dëmtojnë litarët metalikë; ose
- b) të mos rrëshqasin, me përjashtim të rasteve kur rrëshqitja nuk ndikon dukshëm në sigurinë e kabinës, të mjetit tërheqës apo instalimit, nën kushtet më të pafavorshme.

9.5.3 Dyert e kabinave duhet të projektohen dhe të ndërtohen në mënyrë të tillë që të mundësohet mbyllja dhe bllokimi i tyre.

Dyshemeja dhe muret e kabinës duhet të projektohen dhe të ndërtohen që të përballojnë, nën çdo rrethanë, si presionin, ashtu dhe ngarkesat e ushtruara nga përdoruesit.

9.5.4 Nëse për arsye të sigurisë funksionale kërkohet një operator në bordin e kabinës, atëherë kabina pajiset me mjetet e duhura për të kryer detyrat e tij.

9.5.5 Kabinat dhe/ose mjetet tërheqëse dhe, veçanërisht, mekanizmat e tyre të qëndrimit pezull duhet të projektohen dhe të pajisen që të garantojnë sigurinë e punonjësve që u shërbejnë atyre në përputhje me rregullat dhe instruksionet përkatëse.

9.5.6 Në rastin e kabinave të pajisura me mekanizma stakimi, duhet të merren të gjitha masat për të ndaluar, pa rrezikuar përdoruesit, në momentin e nisjes, në çdo kabinë, mekanizmi i së cilës nuk është lidhur mirë me litarët metalikë dhe, në momentin e mbërritjes, çdo kabinë, mekanizmi i së cilës nuk është i stakuar. Gjithashtu, duhet të merren masa për të parandaluar rënien e kabinës.

9.5.7 Mjetet hekurudhore funikulare dhe, për aq sa e lejon konfigurimi i instalimit, kabinat me dy litarë metalikë duhet të pajisen me një mekanizëm frenimi automatik të vendosur mbi trase, kur mundësia e këputjes së litarit tërheqës nuk mund të përjashtohet plotësisht.

9.5.8 Kur nuk është e mundur të eliminohen rreziqet e përmbysjes së kabinës me anë të masave të tjera, atëherë kabina duhet të pajiset me një pajisje kundër përmbysjes, e cila bën të mundur që kabina të ndalet pa rrezikuar njerëzit.

9.6 Pajisjet për përdoruesit

Qasja në hapësirat e hipjes dhe dalja nga hapësirat e zbritjes, si dhe hipja e zbritja e përdoruesve, duhet të organizohet duke pasur parasysh lëvizjen dhe ndalimin e kabinave, në atë mënyrë që të garantohet siguria e njerëzve, veçanërisht në hapësirat ku ka rrezik për rënie.

Për fëmijët dhe për njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të jetë i mundur përdorimi i sigurt i instalimit, në qoftë se ky është projektuar për transportimin e njerëzve të tillë.

9.7. Funksionaliteti

9.7.1 Siguria

9.7.1.1 Duhet të merren të gjitha masat teknike për të siguruar se instalimi do të përdoret për qëllimin e synuar në përputhje me specifikimet e tij teknike dhe kushtet e specifikuara të funksionimit dhe se instruksionet për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sigurt duhet të jenë në përputhje me qëllimin e përdorimit.

Udhëzuesi i përdorimit dhe shënimet përkatëse hartohen në shqip.

9.7.1.2 Njerëzit përgjegjës për operimin e instalimit duhet të pajisen me burimet e nevojshme materiale dhe duhet të jenë të kualifikuar për të kryer detyrën e ngarkuar.

9.7.2 Siguria në rastin kur instalimi nuk është në gjendje pune

Kur instalimi nuk është në gjendje pune dhe nuk mund të riniset së shpejti, duhet të ndërmerren dhe të adoptohen të gjitha procedurat dhe masat teknike për të siguruar se përdoruesit do të jenë të sigurt brenda një afati të caktuar kohor, konform tipit të instalimit dhe mjedisit të tij rrethues.

9.7.3 Dispozita të tjera të veçanta që lidhen me sigurinë

9.7.3.1 Vendet e qëndrimit dhe të punës për punonjësit e shërbimit

Pjesët e lëvizshme në stacion, të cilat janë lehtësisht të arritshme, duhet të projektohen, ndërtohen dhe montohen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo rrezik, ose kur rreziqe të tilla ekzistojnë, duhet të vendosen pajisje mbrojtëse, në mënyrë që të parandalohet kontakti me pjesët e instalimit që mund të shkaktojnë aksident. Këto pajisje mbrojtëse duhet të jenë të tilla që të mos të mund të hiqen lehtësisht ose të bëhen të papërdorshme.

9.7.3.2 Rreziku i rënies

Vendet dhe ambientet e punës, duke përfshirë dhe ato që përdoren me raste, dhe hyrjet në to, duhet të projektohen dhe ndërtohen në atë mënyrë që të parandalojnë rënien e personave që duhet të punojnë ose të lëvizin në to.

Nëse ndërtimi nuk është i përshtatshëm, vendet dhe ambientet e punës duhet të kenë pika ankorimi për pajisjet personale mbrojtëse për të parandaluar rëniet.

10. Analiza mbi sigurinë

Analiza mbi sigurinë, e kërkuar për çdo instalim të teleferikëve, që janë referuar në pikën 1.5 të këtij rregulli teknik, duhet të marrë parasysh çdo mënyrë të parashikuar të përdorimit. Analiza duhet të bëhet sipas një metode të njohur ose të përcaktuar dhe duhet të marrë parasysh nivelin teknologjik dhe

kompleksitetin e instalimit në fjalë.

Analiza mbi sigurinë synon, gjithashtu, që të sigurojë se projektimi dhe konfigurimi i instalimit ka marrë parasysh mjedisin përreth dhe situatat më të pafavorshme për të garantuar kushtet më të pranueshme të sigurisë.

Analiza duhet të mbulojë, gjithashtu, edhe mekanizmat e sigurisë dhe ndikimin e tyre mbi instalim dhe mbi nënsistemet përkatëse që ato vënë në punë, në mënyrë që ato të jenë:

a) në gjendje për të kundërvepruar ndaj një avarie apo dëmtimi fillestar të konstatuar, duke e mbajtur sistemin ose në një gjendje që garanton sigurinë, ose në një nivel më të ulët funksionimi, ose në ndalesë të sigurt (gjendje defekt - siguri);

b) janë me tepricë dhe të monitoruara; ose

c) të tilla që mundësia për dëmtimin e tyre të mund të vlerësohet dhe ato të jenë të një standardi të barasvlershëm me atë që arrihet nga pajisjet e sigurisë që plotësojnë kriteret e dhëna në paragrafët 10 a) dhe 10 b).

Analiza mbi sigurinë duhet të përdoret për të hartuar listën e risqeve dhe situatat e rrezikshme në përputhje me pikën 1.12 të këtij rregulli teknik dhe për të përcaktuar listën e komponentëve të sigurisë të referuar në pikën 1.13. Rezultati i analizës së sigurisë duhet të përmbledhet në një raport mbi sigurinë.

11. Komponentët e sigurisë: Deklarata EC e konformitetit

Kjo dispozitë zbatohet për komponentët e sigurisë të referuar në pikën 1.5 të këtij rregulli teknik dhe synon të tregojë përputhjen e tyre me kërkesat thelbësore që lidhen me to të referuara në pikën 1.8 dhe të përcaktuara në pikën 9 të rregullit teknik.

Deklarata EC e konformitetit dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë të datuara dhe firmosura. Ato duhet të hartohen në shqip ashtu si edhe udhëzuesi i përdorimit i referuar në pikën 9.7.1.1.

Deklarata duhet të japë të dhënat e mëposhtme:

a) referimet me këtë rregull teknik;

b) emrin, emrin e biznesit dhe adresën e plotë të fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

Përfaqësuesi i autorizuar, gjithashtu, duhet të japë emrin, emrin e biznesit dhe adresën e plotë të fabrikuesit;

c) përshkrimin e komponentit (marka, tipi etj.);

d) detajime mbi procedurën e përdorur për deklaratën e konformitetit (pikat nga 2.3 deri në 2.7 të këtij rregulli teknik);

e) të gjitha përcaktimet përkatëse me të cilat duhet të përputhet komponenti dhe në mënyrë të veçantë kushtet e përdorimit;

f) emrin dhe adresën e organit të autorizuar/organizëm europian, të përfshirë në procedurën e konformitetit dhe datën e certifikatës EC të shqyrtimit me detajime, atje kur kjo kërkohet, mbi afatin dhe kushtet e vlefshmërisë së certifikatës;

g) atje ku kërkohet, referimin e standardeve të harmonizuara, të zbatuara;

h) identifikimin e personit të autorizuar që firmos në emër të fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

12. Komponentët e sigurisë: Vlerësimi i konformitetit

12.1 Fusha e përdorimit

Kjo dispozitë zbatohet për komponentët e sigurisë me synimin për të kontrolluar përputhjen me kërkesat thelbësore të referuara në pikën 1.8 dhe të përcaktuara në pikën 9 të këtij rregulli teknik. Kjo dispozitë ka të bëjë me vlerësimin nga një ose me shumë organe të autorizuara/organizma europianë, të përputhshmërisë së brendshme të një komponenti, i konsideruar i veçuar, me specifikimet e cilësuar teknike.

12.2 Procedurat

Procedurat e vlerësimit që zbatohen nga organet e autorizuara/organizma europianë, si në fazën e projektimit ashtu edhe në atë të fabrikimit bazohen në modulet e përcaktuar më poshtë.

Zgjidhjet konsiderohen se janë të barasvlershme dhe mund të përdoren sipas gjykimit së fabrikuesit.

12.3 Moduli B: Shqyrtimi EC i tipit

12.3.1 Ky modul përshkruan atë pjesë të procedurës nëpërmjet të cilës një organ i autorizuar shqiptar/organizëm europian konstaton dhe vërteton se një mostër që përfaqëson produktin, plotëson dispozitat e këtij rregulli teknik.

12.3.2 Aplikimi për shqyrtimin EC të tipit depozitohet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar në një organ të autorizuar/organizëm europian të zgjedhur nga ai vetë.

Aplikimi duhet të përfshijë:

- a) emrin dhe adresën e fabrikuesit dhe, nëse aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i autorizuar, po ashtu emrin dhe adresën e tij;
- b) një deklaratë me shkrim se i njëjti aplikim nuk është depozituar në një tjetër organ të autorizuar/organizëm europian;
- c) dokumentacionin teknik të cilësuar si në pikën 12.3.3.

Aplikanti duhet të vërë në dispozicion të organit të autorizuar/organizmit europian një mostër, përfaqësues të produktit që do të shqyrtohet dhe që më poshtë quhet “tipi”.

Organi i autorizuar/organizmi europian mund të kërkojë mostra të tjerë nëse i nevojiten për kryerjen e programit të testimit.

12.3.3 Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë që të vlerësohet përputhja e komponentit me kërkesat e këtij rregulli teknik.

Lidhur me këtë vlerësim, dokumentacioni teknik duhet që të mbulojë projektimin, prodhimin dhe funksionimin e komponentit.

Dokumentacioni duhet të përmbajë:

- a) një përshkrim të përgjithshëm të tipit;
- b) projektin konceptual, vizatimet e prodhimit dhe skemat e komponentëve, të nënmontimeve, të qarqeve etj.;
- c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar vizatimet dhe skemat e dhëna dhe funksionimin e produktit;
- d) listën e standardeve të harmonizuara shqiptare që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, dhe përshkrimet e zgjidhjeve të adoptuara për të plotësuar kërkesat thelbësore kur standardet e harmonizuara nuk ekzistojnë;
- e) rezultatet e llogaritjeve projektuese, shqyrtimet e kryera etj.;
- f) raportet e provave.

Dokumentacioni teknik, gjithashtu, duhet të tregojë dhe fushën e përdorimit të komponentit.

12.3.4 Organi i autorizuar/organizmi europian duhet:

- a) të shqyrtojë dokumentacionin teknik, të verifikojë që tipi është prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe të identifikojë komponentët, të cilët janë projektuar në përputhje me dispozitat përkatëse të standardeve të harmonizuara, si dhe ato që janë projektuar pa zbatimin e dispozitave përkatëse të këtyre standardeve të harmonizuara;
- b) të kryejë ose të detyrojë kryerjen e shqyrtimeve përkatëse dhe provat e nevojshme për të kontrolluar nëse, atje ku standardet e harmonizuara shqiptare nuk janë zbatuar, zgjidhjet e adoptuara nga fabrikuesi plotësojnë kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik;
- c) të kryejë ose të detyrojë kryerjen e shqyrtimeve përkatëse dhe provat e nevojshme për të kontrolluar nëse, ku fabrikuesi ka zgjedhur të zbatojë standardet përkatëse të harmonizuara, standardet janë vërtet të zbatuara;
- d) të bjerë dakord me aplikantin për vendin ku do të kryen shqyrtimet dhe provat e nevojshme.

12.3.5 Kur tipi plotëson dispozitat e këtij rregulli teknik, organi i autorizuar/organizmi europian lëshon për aplikantin një certifikatë të shqyrtimit EC të tipit. Certifikata përmban emrin dhe adresën e fabrikuesit, konkluzionet e shqyrtimit, kushtet mbi vlefshmërinë e saj, kohëzgjatjen dhe jep të dhënat e nevojshme mbi identifikimin e tipit të aprovuar.

Një listë mbi përmbajtjen e dokumentacionit teknik duhet të jetë si aneks i certifikatës dhe një kopje mbahet nga organi i autorizuar/organizmi europian.

Nëse organi i autorizuar/organizmi europian refuzon t'i lëshojë fabrikuesit një certifikatë EC të tipit, ai duhet të japë arsye të detajuara mbi këtë refuzim. Dispozita kërkon një procedurë apelimi.

12.3.6 Aplikanti informon organin e autorizuar/organizmin europian që mban dokumentacionin teknik të lidhur me certifikatën e shqyrtimit EC të tipit me të gjitha modifikimet mbi komponentin e aprovuar, i cili duhet të marrë një aprovim shtesë atje ku ndryshimet mund të ndikojnë në përputhjen e komponentit me kërkesat thelbësore për kushteve e cilësuar për përdorimin e tij. Ky aprovim shtesë jepet në formën e një shtojce në certifikatën origjinale të shqyrtimit EC të tipit.

12.3.7 Çdo organ i autorizuar/organizëm europian u komunikon organeve të tjera të autorizuar/organizma europianë informacionin e përshtatshëm në lidhje me certifikatat e shqyrtimit EC

të tipit dhe shtojcat e lëshuara dhe të tërhequra.

12.3.8 Organet e tjera të autorizuar/organizma europianë mund të marrin kopje të certifikatave të shqyrtimit EC të tipit dhe/ose shtojcat e tyre. Anekset e certifikatave mbahen në dispozicion të organeve të tjera të autorizuar/organizma europianë.

12.3.9 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të ruajë me dokumentacionin teknik edhe kopje të certifikatave të shqyrtimit EC të tipit dhe shtojcat e tyre për së paku 30 vjet pas prodhimit të komponenti të fundit.

Kur prodhuesi dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk janë brenda Shqipërisë, atëherë detyrimi për të ruajtur dokumentacionin e disponueshëm është përgjegjësi e personit, i cili ka vendosur komponentin në treg.

12.4. Moduli D: Sigurimi i cilësisë së prodhimit

12.4.1. Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës fabrikuesi, i cili plotëson detyrimet e pikës 12.4.2 siguron dhe deklaron se komponentët përkatës janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin CE në çdo komponent dhe harton me shkrim një deklaratë të konformitetit.

Markimi CE shoqërohet nga simboli i identifikimit i organit të autorizuar shqiptar/organizmit europian, përgjegjës për monitorimin, si është cilësuar në pikën 12.4.4.

12.4.2 Fabrikuesi duhet të zbatojë një sistem të aprovuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin e komponentit përfundimtar dhe testimin si është cilësuar në pikën 12.3.3 dhe është objekt i monitorimit si është cilësuar në pikën 12.4.4.

12.4.3 Sistemi i cilësisë

12.4.3.1 Fabrikuesi depoziton një aplikim për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për komponentët përkatës pranë një organi të autorizuar shqiptar/organizëm europian të zgjedhur nga vetë ai.

Aplikimi duhet të përfshijë:

- a) të gjithë informacionin që lidhet me kategorinë e komponentit të shqyrtuar;
- b) dokumentacionin që lidhet me sistemin e cilësisë;
- c) nëse kërkohet, dokumentacionin teknik të tipit të aprovuar dhe një kopje e certifikatës së shqyrtimit EC të tipit.

12.4.3.2 Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhshmërinë me tipin, siç është përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit, si dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e adoptuara nga fabrikuesi dokumentohen me shkrim në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe instruksioneve.

Dokumentacioni i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të saktë të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe regjistrimeve.

Dokumentacioni duhet të përmbajë veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm mbi:

- a) objektivat e cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhimit në lidhje me cilësisë e komponentit;
- b) prodhimin, kontrollin e cilësisë dhe teknikat e sigurimit të cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që do të përdoren;
- c) shqyrtimet dhe provat që kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe frekuencat me të cilat ato do të kryhen;
- d) regjistrimet e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi provat, të dhëna mbi kalibrimin, raporte mbi kualifikimin e personelit të lidhur me to etj.;
- e) mjetet për të monitoruar arritjen e cilësisë së kërkuar të komponentit dhe funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë.

12.4.3.3 Organi i autorizuar/organizmi europian vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat që janë referuar në pikën 12.4.3.2.

Ky organ presupozon përputhjen me këto kërkesa në lidhje me sistemet e cilësisë që zbatojnë standardet e harmonizuar përkatës.

Ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së komponentit përkatës. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në ambientet e fabrikuesit.

Vendimi i njoftohet fabrikuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

12.4.3.4 Fabrikuesi merr përsipër të përmbushë detyrimet që dalin nga sistemi i cilësisë, si është aprovuar, dhe e mban atë në një mënyrë të përshtatshme dhe në një nivel të përshtatshëm dhe efikas.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban organin e autorizuar/organizmin europian që ka aprovuar sistemin e cilësisë të informuar për çdo ndryshim të parashikuar në sistemit të cilësisë.

Organi i autorizuar/organizmi europian vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë plotëson akoma kërkesat e referuara në pikën 12.4.3.2 ose nëse kërkohet një rivlerësim.

Ai njofton fabrikuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

12.4.4 Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmit europian

12.4.4.1 Qëllimi i mbikëqyrjes është që të sigurojë se fabrikuesi përmbush në vazhdimësi detyrimet që dalin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

12.4.4.2 Fabrikuesi lejon organin e autorizuar/organizmin europian të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit, dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht mbi:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) regjistrimet mbi cilësinë, të tilla si raporte inspektimi dhe rezultate të provave, të dhëna kalibrimi, raporte mbi kualifikimet e personelit të lidhur me to etj.

12.4.4.3 Organi i autorizuar/organizmi europian kryen periodikisht auditime që të sigurohet se fabrikuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i jep fabrikuesit një raport auditimi.

12.4.4.4 Organi i autorizuar/organizmi europian mund të bëjë vizita të papritura te fabrikuesi. Gjatë këtyre vizitave, nëse është e nevojshme, organi i autorizuar/organizmi europian mund të kryejë ose të detyrojë të kryhen prova për të verifikuar që sistemi i cilësisë funksionon korrektësisht.

Organi i autorizuar/organizmi europian i jep fabrikuesit një raport mbi vizitën dhe, nëse është kryer një provë, një raport të provës.

12.4.5 Fabrikuesi, për një periudhë së paku 30 vjet, pasi është prodhuar komponenti i fundit, mban në dispozicion të autoritetit kombëtar:

a) dokumentacionin e referuar në paragrafin 12.4.3.1;

b) përditësimin e referuar në paragrafin e dytë të pikës 12.4.3.4;

c) vendimet dhe raportet e organit të autorizuar/organizmit europian, të cilat janë të referuara në pikat 12.4.3.4, 12.4.4.3 dhe 12.4.4.4.

12.4.6 Çdo organ i autorizuar/organizëm europian u jep organeve të tjera të autorizuar/organizmave europianë informacionin përkatës në lidhje me të gjitha aprovimet e sistemit të cilësisë të lëshuara dhe të tërhequra.

12.5 Moduli F: Verifikimi i produktit

12.5.1 Ky modul përshkruan procedurën, me anë të së cilës një fabrikues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar kontrollon dhe deklaron se komponentët që janë objekt i kërkesave të pikës 12.5.3 janë në përputhje me tipin e cilësuar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik.

12.5.2 Fabrikuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit të sigurojë përputhshmërinë e komponentëve me tipin e cilësuar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik. Ai vendos markimin CE në çdo komponent dhe harton një deklaratë të konformitetit.

12.5.3 Organi i autorizuar/organizmi europian kryen shqyrtimet dhe provat e nevojshme, me qëllim që të kontrollojë përputhshmërinë e komponentëve me kërkesat e këtij rregulli teknik, dhe sipas zgjedhjes së fabrikuesit ose nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të çdo komponenti, si është cilësuar në pikën 12.5.4, ose nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të komponentëve mbi një bazë statistikore, si është cilësuar në pikën 12.5.5.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ruan një kopje të deklaratës së konformitetit për një periudhë së paku 30 vjet pas prodhimit të komponentit të fundit.

12.5.4 Verifikimi nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të çdo komponenti

12.5.4.1 Të gjithë komponentët shqyrtohen individualisht dhe bëhen provat e duhura, si është dhënë në standardin/et përkatës të harmonizuar ose kryhen prova të barasvlershme, me qëllim që të verifikohet përputhshmëria e tyre me tipin e cilësuar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik.

12.5.4.2 Organi i autorizuar/organizmi europian vendos ose kërkon të vendoset simboli i tij i identifikimit në çdo komponent të aprovuar dhe harton me shkrim një certifikatë të konformitetit në lidhje me provat e kryera.

12.5.4.3 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të sigurojë se është në gjendje t'i paraqesë organit të autorizuar/organizmit europian certifikatat e konformitetit, nëse i kërkohet.

12.5.5 Verifikimi statistikor

12.5.5.1 Fabrikuesi duhet t'i paraqesë komponentët e tij në formën e grupeve të njëjta dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit të sigurojë njëtrajtshmërinë e çdo grupi të prodhuar.

12.5.5.2 Të gjithë komponentët duhet të jenë në dispozicion për verifikim në formën e grupeve të njëjta. Një mostër e rastësishme duhet të merret nga çdo grup. Komponentët në një mostër shqyrtohen individualisht dhe testohen si është dhënë në standardin/et e harmonizuar, ose kryhen prova të barasvlershme që të sigurohet përputhja e tyre me kërkesat e këtij rregulli teknik dhe përcakton nëse grupi pranohet ose refuzohet.

12.5.5.3 Procedura statistikore duhet të përdorë elementet e mëposhtme:

a) një metodë statistikore;

b) një plan për marrjen e mostrave me karakteristikat e veta funksionale.

12.5.5.4 Në rastin e grupeve të pranuara, organi i autorizuar/organizmi europian vendos ose kërkon të vendoset numri i tij i identifikimit në çdo komponent dhe harton me shkrim një certifikatë të konformitetit të lidhur me provat e kryera. Të gjithë komponentët e grupit mund të vendosen në treg, duke përjashtuar ata komponentë që në grup u gjetën me mospërputhje.

Nëse një grup refuzohet, organi i autorizuar/organizmi europian ose autoriteti kompetent merr masat e duhura për të parandaluar vendosjen e atij grupi në treg.

Nëse grupe të tilla refuzohen shpesh, organi i autorizuar/organizmi europian mund të ndërpresë verifikimin statistikor.

Fabrikuesi, nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmit europian, mund të vendosë gjatë procesit të prodhimit numrin e identifikimit të këtij të fundit.

12.5.5.5 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të sigurojë se ai është në gjendje t'i paraqesë organit të autorizuar/organizmit europian certifikatat e konformiteti.

12.6 Moduli G: Verifikimi i njësisë

12.6.1 Ky modul përshkruan procedurën, me anë të së cilës fabrikuesi siguron dhe deklaron se komponenti përkatës, i cili është i pajisur me certifikatën e referuar në pikën 12.6.2, është në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik që janë të zbatuara në të.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin CE në komponent dhe harton një deklaratë të konformitetit.

12.6.2 Organi i autorizuar/organizmi europian shqyrton komponentin e sigurisë dhe kryen provat e duhura të dhëna në standardet e harmonizuara përkatëse ose kryen prova të barasvlershme, për të siguruar përputhshmërinë e tij me kërkesat përkatëse të këtij rregulli teknik.

Organi i autorizuar/organizmi europian vendos ose kërkon të vendoset numri i tij i identifikimit mbi komponentin e aprovuar dhe harton një certifikatë të konformiteti të lidhur me provat e kryera.

12.6.3 Qëllimi i dokumentacionit teknik është që të mundësojë të vlerësohet përputhshmëria me kërkesat e këtij rregulli teknik dhe të kuptohet projekti, prodhimi dhe funksionimi i komponentit.

Për qëllime të vlerësimit, dokumentacioni duhet të përfshijë:

a) një përshkrim të përgjithshëm të tipit;

b) projektin konceptual dhe vizatimet e prodhimit, skemat e komponentëve, nënmontimeve, qarqet etj.;

c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme mbi kuptimin e vizatimeve dhe skemave të dhëna dhe funksionin e komponentit;

d) një listë të standardeve të harmonizuara që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, si dhe përshkrimet e zgjidhjeve të adoptuara nga fabrikuesi për të plotësuar kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik atje ku standardet e harmonizuara nuk janë zbatuar;

e) rezultatet e llogaritjeve të bëra gjatë projektimit, shqyrtimet e kryera etj.;

f) raporte të provave;

g) fushat e përdorimit të komponentëve.

12.7 Moduli H: Sigurimi i plotë i cilësisë

12.7.1 Ky modul përshkruan procedurën, me anë të së cilës një fabrikues, i cili plotëson detyrimet e pikës 12.7.2, siguron dhe deklaron se komponentët në fjalë plotësojnë kërkesat përkatëse të këtij rregulli teknik.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin CE në komponent, si dhe harton me shkrim një deklaratë të konformitetit.

Markimi CE shoqërohet nga simboli i identifikimit i organit të autorizuar/organizmit europian, përgjegjës për mbikëqyrjen, si është cilësuar në pikën 12.7.4.

12.7.2 Fabrikuesi zbaton një sistem të aprovuar të cilësisë në projektim, prodhim, inspektimin e komponentit përfundimtar dhe testim, si është cilësuar në pikën 12.7.3 dhe është subjekt i mbikëqyrjes, si është cilësuar në pikën 12.7.4.

12.7.3 Sistemi i cilësisë

12.7.3.1 Fabrikuesi depoziton një aplikim për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë pranë një organi të autorizuar/organizm europian.

Aplikimi duhet të përfshijë:

- a) të gjithë informacionin që lidhet me kategorinë e komponentit të parashikuar;
- b) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë.

12.7.3.2 Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhshmërinë e komponentëve me kërkesat përkatëse të këtij rregull teknik.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e adoptuara nga fabrikuesi dokumentohen me shkrim në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve.

Dokumentacioni i sistemit të cilësisë duhet të sigurojë një kuptim të saktë të politikave dhe procedurave të cilësisë, si: plane, manuale, regjistrime dhe programe të cilësisë.

Dokumentacioni duhet të përmbajë veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm mbi:

- a) objektivat e cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhimit në lidhje me cilësinë e projektimit dhe të komponentit;
- b) specifikimet teknike të projektimit, duke përfshirë standardet e harmonizuara që zbatohen dhe, atje ku standardet e harmonizuara nuk zbatohen plotësisht, mjetet që përdoren për të siguruar se kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik të zbatuara të produktet plotësohen;
- c) kontrollin e projektit dhe teknikat e verifikimit të projektit, proceset dhe veprimet sistematike që përdoren kur projektimi i komponentëve përshtatet me kategorinë e komponentëve të mbuluar;
- d) prodhimin korrespondues, kontrollin e cilësisë dhe teknikat e sigurimit të cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që përdoren;
- e) shqyrtimet dhe provat që kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit, dhe frekuencën me të cilat ato do të kryhen;
- f) regjistrimet e cilësisë, të tilla si: raporte inspektimi dhe rezultate të provave, të dhëna mbi kalibrimet, raporte mbi kualifikimin e personelit të lidhur me to etj.;
- g) mjetet për të monitoruar arritjen e cilësisë së kërkuar të projektimit dhe të komponentit, si dhe funksionimin efektiv të sistemit të sigurimit të cilësisë.

12.7.3.3 Organi i autorizuar/organizmi europian vlerëson sistemin e cilësisë, për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e referuara në pikën 12.7.3.2. Ai presupozon përputhjen me këto kërkesa në lidhje me sistemet e cilësisë që zbaton standardi përkatës i harmonizuar.

Ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë si vlerësues i teknologjisë së produktit përkatës. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e fabrikuesit.

Vendimi i njoftohet fabrikuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

12.7.3.4 Fabrikuesi merr përsipër të plotësojë detyrimet e dala nga sistemi i cilësisë, si është aprovuar dhe e mbështet atë që ai të jetë i përshtatshëm dhe efektiv.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban të informuar organin e autorizuar/organizmin europian që ka aprovuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim të parashikuar të sistemit të cilësisë.

Organi i autorizuar/organizmi europian vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë i plotëson akoma kërkesat që janë referuar në paragrafin 12.7.3.2 ose nëse kërkohet një rivlerësim i tij.

Ai njofton fabrikuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

12.7.4 Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmit europian

12.7.4.1 Qëllimi i mbikëqyrjes është që të sigurohet se fabrikuesi përmbush në vazhdimësi detyrimet e dala nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

12.7.4.2 Fabrikuesi lejon organin e autorizuar/organizmin europian të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e projektimit, prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit, dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht mbi:

- a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- b) regjistrimet mbi cilësinë që merren nga sistemi i cilësisë për pjesën e projektimit, si: rezultate të analizave, llogaritjeve, provave etj.;
- c) regjistrimet mbi cilësinë që merren nga sistemi i cilësisë për pjesën e prodhimit, si: raporte inspektimi dhe rezultate të provave, të dhëna kalibrimi, raporte mbi kualifikimet e personelit të lidhur me to etj.

12.7.4.3 Organi i autorizuar/organizmi europian periodikisht kryen auditime që të sigurohet se fabrikuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i jep fabrikuesit një raport auditimi.

12.7.4.4 Përveç kësaj, organi i autorizuar/organizmi europian mund të bëjë vizita të palajmëruara te fabrikuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i autorizuar/organizmi europian, mund të kryejë prova ose të detyrojë të kryhen ato, me qëllim që të kontrollojë, nëse është e nevojshme, funksionimin e duhur të sistemit të cilësisë: ai i jep fabrikuesit një raport mbi vizitën dhe, nëse është kryer një provë, një raport mbi provën.

12.7.5 Fabrikuesi, për një periudhë së paku 30 vjet pasi është prodhuar komponenti i fundit, ruan në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

- a) dokumentacionin, si referohet në pikën 12.7.3.1;
- b) përditësimet që janë të referuara në pikën 12.7.3.4;
- c) vendimet dhe raportet e organit të autorizuar/organizmit europian, të cilat janë të referuara në pikat 12.7.3.4, 12.7.4.3 dhe 12.7.4.4.

12.7.6 Çdo organ i autorizuar/organizëm europian u jep organeve të tjera të autorizuar/organizmave europianë informacionin e lidhur me aprovimet e sistemit të cilësisë të lëshuara dhe ato të shfuqizuara.

12.7.7 Kërkesa suplementare; shqyrtimi i projektimit

12.7.7.1 Fabrikuesi depoziton një aplikim për shqyrtimin e projektimit vetëm në një organ të autorizuar/organizëm europian.

12.7.7.2 Aplikimi duhet të mundësojë kuptimin e projektimit, prodhimit dhe funksionimit të komponentit, si dhe vlerësimin e konformitetit me kërkesat e këtij rregulli teknik.

Ai duhet të përfshijë:

a) specifikimet teknike të projektimit, duke përfshirë standardet e harmonizuara që do të zbatohen;

b) evidencën që nevojitet për të mbështetur përshtatshmërinë e tyre, veçanërisht atje ku standardet e harmonizuara nuk zbatohen plotësisht. Evidenca mbështetëse duhet të përfshijë rezultatet e provave të kryera nga laboratorit përkatës i fabrikuesit ose në emër të tij.

12.7.7.3 Organi i autorizuar/organizmi europian shqyrton aplikimin dhe atje ku projektimi plotëson dispozitat e këtij rregulli teknik, i lëshon aplikantit një certifikatë EC të shqyrtimit të projektimit. Certifikata përmban konkluzionet e shqyrtimit, kushtet e vlefshmërinë së saj, të dhënat e nevojshme për identifikimin e projektimit të aprovuar dhe nëse duhet, një përshkrim të funksionit të komponentit.

12.7.7.4 Aplikanti e mban organin e autorizuar/organizmin europian që ka lëshuar certifikatën EC të shqyrtimit të projektimit të informuar mbi çdo modifikim në projektimin e aprovuar. Modifikimet në projektimin e aprovuar duhet të marrin një aprovim plotësues nga organi i autorizuar/organizmi europian që ka lëshuar certifikatën EC të shqyrtimit të projektimit atje ku ndryshime të tilla mund të ndikojnë në përputhshmërinë me kërkesat thelbësore, si të referuara në pikën 1.8 të këtij rregulli teknik ose të kushteve të cilësuara për përdorimin e komponentit. Ky aprovim plotësues jepet në formën e një shtojce në certifikatën origjinale të shqyrtimit EC të projektimit.

12.7.7.5 Organet e autorizuar/organizmat europianë dërgojnë tek organet e tjera të autorizuar/organizma europianë informacionin përkatës të lidhur me:

- a) certifikatat e shqyrtimit EC të projektimit dhe shtojcat e lëshuara;
- b) aprovimet EC të projektimit dhe shtojcat e anuluar;
- c) certifikatat e shqyrtimit EC të projektit dhe shtojcat e refuzuara.

13. Nën sistemet: Deklarimi EC i konformitetit

Kjo dispozitë zbatohet për nën sistemet e referuara në pikën 3.2 të këtij rregulli teknik, me qëllim që të sigurohet se ato plotësojnë kërkesat thelbësore të lidhura me to dhe të referuara në pikën 1.8 të këtij rregulli teknik.

Deklarata EC e konformitetit hartohet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, ose atje ku një person i tillë nuk është i gatshëm, nga çdo person fizik ose juridik, i cili vendos nën sistemin në treg; deklarata dhe dokumentacioni teknik që e shoqëron atë duhet të datohen dhe të firmosen.

Deklarata EC e konformitetit dhe dokumentacioni teknik duhet të jenë në shqip dhe të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- a) referimin e këtij rregulli teknik;
- b) emrin dhe adresën e personit, i cili ka kërkuar shqyrtimin EC;
- c) një përshkrim të nën sistemit;
- d) emrin dhe adresën e organit të autorizuar/organizmit europian, i cili ka kryer shqyrtimin EC, si është referuar në pikën 4 të këtij rregulli teknik;
- e) të gjitha dispozitat përkatëse, të cilat nën sistemi duhet të plotësojë, veçanërisht kufizime në përdorim ose të kushteve të përdorimit;
- f) rezultatet e shqyrtimit EC të referuara në pikën 14 (certifikata EC e konformitetit);
- g) të dhëna mbi personin, i cili është i autorizuar të firmosë një deklaratë ligjore detyruese për fabrikuesin ose përfaqësuesin e tij të autorizuar, ose atje ku një person i tillë nuk është i gatshëm, personi fizik ose juridik, i cili vendos nën sistemin në treg.

14. Nën sistemet: Vlerësimi i konformitetit

14.1 Shqyrtimi EC është procedura, me anë të së cilës me kërkesë të fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, ose atje ku një person i tillë nuk është i gatshëm, të çdo personi fizik ose juridik, i cili pranon përgjegjësinë për vendosjen e nën sistemit në treg, një organ i autorizuar/organizëm europian kontrollon dhe vlerëson se një nën sistem është:

- a) në përputhje me dispozitat e rregullit teknik dhe dispozita të tjera të përshtatshme;
- b) në përputhje me dokumentacionin teknik dhe i kompletuar.

14.2 Shqyrtimi i nën sistemit kryhet në secilën prej fazave të mëposhtme:

- a) projektim;
- b) ndërtim dhe pranim i provave sapo që nën sistemi të jetë kompletuar.

14.3 Dokumentacioni teknik që shoqëron certifikatën e shqyrtimit përfshin:

a) planet e ndërtimit dhe llogaritjet, skemat elektrike dhe hidraulike, skemat e qarqeve të kontrollit, përshkrimin e sistemeve automatike dhe kompjuterëve, instruksionet mbi përdorimin dhe shërbimin etj.;

b) listën e komponentëve të sigurisë të referuar në pikën 1.11 të këtij rregulli teknik dhe që janë përdorur në nën sistem;

c) kopje të deklaratës EC të konformitetit për këta komponentë të sigurisë, si është përshkruar në pikën 11 së bashku me planet korresponduese të konstruksionit dhe një kopje të raporteve për çdo provë dhe eksperiment tjetër të kryer.

14.4 Dokumentacioni dhe korrespondenca në lidhje me procedurat EC të shqyrtimit duhet të hartohen në shqip.

14.5 Mbikëqyrja

14.5.1 Nëpërmjet mbikëqyrjes duhet të sigurohet se gjatë ndërtimit të nën sistemit janë plotësuar detyrimet e dala nga dokumentacioni teknik.

14.5.2 Organi i autorizuar/organizmi europian përgjegjës për shqyrtimin EC ka të drejtë për të hyrë dhe për të vizituar repartet e prodhimit, vendet e magazinimit dhe, atje ku është e nevojshme, vendet e parafabrikimit, impiantet e testimit dhe në përgjithësi të çdo vendi që ai e ka të nevojshëm për të kryer detyrat e tij. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose, aty ku një person i tillë nuk është i gatshëm, personi fizik ose juridik, i cili vendos nën sistemin në treg, i siguron atij, ose vë në dispozicion të tij çdo dokument që kërkohet për këtë qëllim, veçanërisht planet dhe dokumentacionin teknik në lidhje me nën sistemin.

14.5.3 Organi i autorizuar/organizmi europian përgjegjës për shqyrtimin EC kryen periodikisht auditime për të siguruar përputhshmërinë me dispozitat e këtij rregulli teknik. Në çdo vizitë ai i jep mbikëqyrësit përgjegjës në vendndodhje një raport auditimi. Ai mund kërkojë të jetë prezent për të inspektuar faza të ndryshme të punës.

14.5.4 Përveç kësaj, organi i autorizuar/organizmi europian mund të kryejë vizita të papritura në repartet e prodhimit. Gjatë këtyre vizitave ai mund të kryejë auditime të plota ose pjesore.

Organi i autorizuar/organizmi europian harton një raport mbi vizitën dhe, atje ku është e nevojshme, paraqet një raport auditi të mbikëqyrësi përgjegjës.

14.6. Çdo organ i autorizuar/organizëm europian publikon periodikisht informacionin përkatës në lidhje me:

- a) të gjitha aplikimet e marra për shqyrtimin EC;
- b) të gjitha certifikatat e lëshuara të shqyrtimit EC;
- c) të gjitha certifikatat e refuzuara të shqyrtimit EC.

15. Kriteret minimale që duhen marrë parasysh për organet e autorizuar shqiptare

15.1 Organi i autorizuar, drejtori i tij dhe stafi përgjegjës për kryerjen e veprimeve të verifikimit nuk mund të jenë projektues, prodhues, furnizues ose instalues të komponentëve të sigurisë ose nënsistemeve, të cilat inspektojnë, ose përfaqësues të autorizuar të çdonjërës prej këtyre grupeve, ose person fizik ose juridik që vendos këta komponentë të sigurisë apo nënsisteme në treg. Ata nuk mund të përfshihen as drejtpërdrejt as si përfaqësues të autorizuar në projektim, prodhim, ndërtim, marketim, shërbim ose vënien në funksionim të këtyre komponentëve të sigurisë apo nënsistemeve. Kjo nuk përjashton mundësinë e shkëmbimeve të informacionit teknik ndërmjet fabrikuesit dhe organit të autorizuar.

15.2 Organi i autorizuar dhe stafi i tij i inspektimit duhet të kryejnë veprimet e verifikimit në shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencës teknike dhe duhet të jenë të lirë nga të gjitha presionet dhe nxitjet, veçanërisht financiare, të cilat mund të ndikojnë në gjykimin e tyre ose në rezultatet e inspektimit, veçanërisht nga persona ose grupe personash me interes mbi rezultatin e verifikimeve.

15.3 Organi i autorizuar duhet të ketë në dispozicion stafin e nevojshëm dhe të zotërojë mjetet e nevojshme për të qenë në gjendje të realizojë siç duhet detyrat administrative dhe teknike, që lidhen me funksionet e verifikimit; ai duhet të ketë, gjithashtu, mundësinë e disponimit të pajisjeve të nevojshme për verifikime të veçanta.

15.4 Stafi përgjegjës për inspektim duhet të ketë:

- a) formimin/trajnimin e mjaftueshëm teknik dhe profesional;
- b) njohuritë e nevojshme mbi kërkesat e provave që ata kryejnë dhe eksperiencë të mjaftueshme për prova të tilla;
- c) aftësinë e duhur për hartimin e certifikatave, regjistrimeve dhe raporteve që kërkojnë mbi vërtetësinë e kryerjes së provave.


15.5 Paanësia e stafit të inspektimit duhet të garantohet. Shpërblimi i tyre nuk duhet të varet nga numri i provave të kryera ose nga rezultatet e këtyre provave.

15.6 Organi i autorizuar shqiptar siguron përgjegjësinë civile në zbatim të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

15.7 Stafi i organit të autorizuar shqiptar ruan sekretin profesional lidhur me të gjithë informacionin e grumbulluar gjatë kryerjes së detyrave të tij.

16 Markimi CE i konformitetit

Markimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet “CE” që paraqitet në formën e mëposhtme:



Nëse markimi CE zvogëlohet ose zmadhohet, duhet të respektohen raportet e dhëna në vizatimin e mësipërm të shkallëzuar.

Komponentët e ndryshëm të markimit CE duhet të kenë të njëjtën përmasë vertikale dhe që nuk duhet të jetë më pak se 5 mm.

Kjo përmasë minimale mund të mos merret parasysh për komponentët e sigurisë me madhësi të vogël. Markimi CE shoqërohet nga dy shifrat e fundit të vitit që ai është vendosur dhe nga numri i identifikimit të organit të autorizuar/organizmit europian që merret me procedurat e referuara në pikën 2.5 të këtij rregulli teknik.

VENDIM
Nr.1054, datë 22.12.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PAJISJET E REGJISTRIMIT NË TRANSPORTIN RRUGOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 177 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tekstit të rregullores “Për pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në rregulloren “Për organizimin e kohës së punës të personave që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1243, datë 10.9.2008 të Këshillit të Ministrave, shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 2 të kapitullit I, pikat 7.5, 7.6 të kapitullit II, kapitulli VI dhe pikat 34.1, 34.2 e 34.3 të kapitullit VII, shfuqizohen.

3. Në rregulloren “Mbi kontrollin në anë të rrugës dhe në zyrat e ndërmarrjeve, për sa i përket zbatimit të rregullave të kohës së punës për personat që kryejnë transport rrugor, dhe për orët e drejtuesve të mjeteve”, që i bashkëlidhet vendimit nr.207, datë 25.2.2009 të Këshillit të Ministrave, shkronjat “e” dhe “f” të pikës 13 dhe pikat 33 e 34 shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
MBI PAJISJET E REGJISTRIMIT NË TRANSPORTIN RRUGOR¹

KAPITULLI I

1. Parimet e fusha e zbatimit

1.1 Pajisja e regjistrimit brenda kuptimit të kësaj rregulloreje duhet të përputhet për sa i përket konstruksionit, instalimit, përdorimit dhe testimit me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe apendiksit 1 dhe 1B të aneksit, bashkëlidhur tekstit të konsoliduar të marrëveshjes europiane në lidhje me punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR).

1.2 Përkufizimet e përdorura në aneksin 1 të rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008, do të zbatohen edhe për këtë rregullore.

1.3 Pajisjet e regjistrimit do të instalohen dhe përdoren në mjetet e regjistruara për qëllime të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, me përjashtim të mjeteve të përmendura në kryerjen e shërbimeve në përputhje me në pikat 3 dhe 16(1) të rregullores së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008.

1.4 Mjetet e përmendura për kryerjen e operacioneve sipas pikës 15 të rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008, përjashtohen për një periudhë të

¹ Celex No.1985R3821 e 20 dhjetorit, Gazeta Zyrtare L 370, 31.12.1985, f.8 “Mbi pajisjet e regjistrimit”, rregullorja është e njëjtë me aneksin e Marrëveshjes AETR, në të cilën Shqipëria është palë kontraktuese. Aneksi i marrëveshjes nuk përfshin nenet 1, 2 të kapitullit I të rregullores 3821/85.

përkohshme prej jo më shumë se 30 ditë nga zbatimi i dispozitave të kësaj rregulloreje. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit njofton shtetet e tjera anëtare, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR për çdo përjashtim të kryer sipas kësaj pike.

KAPITULLI II MIRATIMI I TIPIT

2. Kriteret e miratimit

2.1 Për qëllime të kësaj rregulloreje, fjalët “pajisje regjistrimi” do të nënkuptojnë “pajisjen e regjistrimit (ose komponentët e saj) ose kartën e tahogرافit” në përputhje me përkufizimin e dhënë në shkronjat “gj” dhe “ll” të aneksit 1.

2.2 Aplikimi për miratimin e tipit të pajisjes së regjistrimit ose të një modeli flete regjistrimi ose të një karte memorie do të paraqitet i shoqëruar me specifikime të përshtatshme, nga prodhuesi ose nga agjenti i tij, në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, më poshtë DPM.

2.2.1 Për tipin e pajisjes së regjistrimit ose të ndonjë flete regjistrimi ose të një karte të memories të miratuar në një vend tjetër, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR, nuk mund të aplikohet përsëri për miratim. Një aplikim për miratim nuk mund të paraqitet më shumë se në një vend, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR.

2.3 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë jep miratimin e tipit për cilindo tip të pajisjes së regjistrimit ose të një modeli flete regjistrimi, ose të një karte të memories, që përmbush kërkesat e vendosura në apendiksin 1 ose 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR, nëse është në gjendje të kontrollojë modelet e prodhuara konform prototipit të miratuar.

2.3.1 Për tahogرافin analog, DPM-ja lëshon certifikatën e miratimit të tipit, sipas modelit të pikës II të apendiksit 1 të aneksit të Marrëveshjes AETR. Një kopje e kësaj certifikate të miratimit të tipit, i shpërndahet të gjitha shteteve anëtare të Marrëveshjes AETR.

2.3.2 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është përgjegjëse për miratimin e tipit për tahogرافet digjitale dhe kartat e tahogرافit. Ajo nuk jep miratimin e tipit për pajisjen e regjistrimit ose kartën e tahogرافit, për aq kohë sa aplikuesi nuk zotëron:

- a) certifikatën e sigurisë;
- b) certifikatën e funksionalitetit;
- c) certifikatën e ndërveprimit.

2.3.3 Në bazë të tri certifikatave të përmendura më sipër, DPM-ja lëshon certifikatën e miratimit të tipit sipas modelit të pikës III të apendiksit 2 të aneksit të Marrëveshjes AETR. Një kopje e kësaj certifikate të miratimit të tipit i shpërndahet të gjitha shteteve anëtare të Marrëveshjes AETR.

2.4 Çdo modifikim ose shtesë në një model të miratuar duhet të marrë miratimin e tipit shtesë nga DPM-ja, nëse ky institucion ka dhënë miratimin e tipit origjinal.

2.5 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, pas miratimit të tipit të pajisjes së regjistrimit ose të një modeli flete regjistrimi ose kartës së memories, së bashku me lëshimin e certifikatës së miratimit sipas pikave 2.3, 2.3.1, 2.3.2 dhe 2.3.3, i lëshon aplikantit markën e miratimit, forma dhe përmbajtja e të cilës janë në përputhje me modelin e treguar në pikën I të apendiksit 2 të aneksit të Marrëveshjes AETR.

2.5.1 Në markën e miratuar, përveç shkronjës “e” e pasuar nga numri ose shkronja dalluese për vendin, i cili ka lëshuar miratimin, do të vendoset dhe një numër miratimi që i korrespondon numrit të certifikatës së miratimit e plotësuar për prototipin e pajisjes së regjistrimit ose fletës së regjistrimit, ose kartës së tahogرافit.

2.5.2 Marka e miratimit shfaqet në pllakën përshkruese të secilit set të pajisjes së kontrollit. Pllaka fiksohet jashtë ose brenda karkasës së pajisjes, në mënyrë të paçmontueshme, si dhe duhet të jetë gjithmonë qartësisht e lexueshme. Informacioni që përmban pllakën përshkruese jepet në pikën 2 të shkronjës “E” të apendiksit 1, për tahogرافin analog, dhe në pikën 24 të kapitullit III të apendiksit 1B, për tahogرافin digjital të aneksit të Marrëveshjes AETR.

2.6 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë njofton brenda 30 ditëve shtetet e tjera për çdo tip të pajisjes së regjistrimit ose të një modeli flete regjistrimi ose kartës së memories, të cilën ajo ka miratuar, si dhe bashkëlidhur njoftimit dërgon një kopje të certifikatës së miratimit të shoqëruar nga kopjet e specifikimet përkatëse.

2.6.1 Në rastin kur DPM-ja refuzon miratimin e tipit të pajisjes së regjistrimit ose të një modeli flete regjistrimi, ose të kartës së memories, ajo duhet të njoftojë shtetet e tjera mbi arsyet e refuzimit të miratimit.

2.7 Nëse DPM-ja, e cila ka dhënë miratimin e tipit, siç parashikohet në pikat 2.3-2.6, zbulon që në disa pajisje regjistrimi ose të një modeli flete regjistrimi ose karta të memories, marka e miratimit të tipit të lëshuar nuk është në përputhje me prototipin e miratuar prej saj, ajo merr masat e nevojshme për të siguruar që modelet e paraqitur të përputhen me prototipin e miratuar. Masat e ndërmarra shtrihen deri në tërheqjen e miratimit të tipit.

2.7.1 Nëse DPM-ja, e cila ka dhënë miratimin e tipit, e tërheq atë kur pajisja e regjistrimit ose modeli i fletës së regjistrimit ose karta e memories, të cilat kanë qenë miratuar nuk janë në përputhje me këtë rregullore ose me apendikset 1 dhe 1B të aneksit 1 të Marrëveshjes AETR, ose kur gjatë përdorimit shfaqin ndonjë defekt të përgjithshëm që i bën ato të papërshtatshme për qëllimin për të cilin janë destinuar.

2.7.2 Në rastin kur DPM-ja, e cila ka dhënë miratimin e tipit, njoftohet nga shtete të tjera për një ose disa raste të përmendura në pikat 2.7 dhe 2.7.1, ajo ndërmerr hapat e nevojshëm sipas këtyre pikave, pas vendimit të marrë në pikën 2.7.5.

2.7.3 Në rastin kur DPM-ja ose organet e kontrollit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.207, datë 25.2.2009, konstatojnë që është shfaqur një prej rasteve të përmendura në pikën 2.7.1, ato ndalojnë deri në një njoftim të mëtejshëm vendosjen në treg dhe futjen në shërbim të pajisjes së regjistrimit ose modeleve të fletëve të regjistrimit ose kartave të memories. E njëjta masë zbatohet për rastet e përmendura në pikën 2.7, për sa i përket pajisjes së regjistrimit ose modeleve të fletëve të regjistrimit, ose kartave të memories, të cilat kanë qenë të përjashtuara nga verifikimi fillestar, nëse prodhuesi, pas njoftimit përkatës, nuk sjell pajisjen në përputhje me modelin e miratuar ose me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2.7.4 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë njofton brenda një periudhe prej 30 ditësh shtetet e tjera për heqjen e miratimit të tipit ose çfarëdo mase tjetër të marrë prej saj, sipas pikave 2.7, 2.7.1 dhe 2.7.2 dhe specifikon arsyet për këto veprime. Njoftimi i shteteve të tjera për heqjen e tipit të miratuar shoqërohet me kopje të certifikatës sipas modelit të treguar në apendiksin 2 të aneksit të Marrëveshjes AETR.

2.7.5 Në rastet kur DPM-ja, e cila ka dhënë miratimin e tipit, diskuton ekzistencën e ndonjë prej rasteve të specifikuara në pikat 2.7 ose 2.7.1, ekspertët e saj do të diskutojnë me ekspertët e shteteve të interesuara deri në marrjen e një vendimi për këtë.

2.8 Një aplikant për miratimin e tipit të një modeli flete regjistrimi do të dëshmojë në aplikimin e tij për tipin ose tipat e pajisjes së regjistrimit për të cilin fleta e regjistrimit, në fjalë është përcaktuar për t'u përdorur dhe do të sigurojë pajisje të përshtatshme për qëllime të testimit për tipin ose tipat e fletës.

2.8.1 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë do të dëshmojë certifikatën e miratimit për tipin ose tipat e modelit të fletës së regjistrimit të pajisjes së regjistrimit, për të cilin përdoret ky model flete.

2.9 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) nuk mund të refuzojë regjistrimin e një mjeti të përshtatur (pajisur) me pajisje regjistrimi, ose të ndalojë futjen në shërbim ose përdorim të mjeteve të tilla, për arsye të lidhur me faktin se mjeti është i përshtatur me pajisje të tillë, nëse pajisja e regjistrimit mban markën e miratimit të përmendur në pikat 2.5 - 2.5.2 të këtij kapitulli dhe pllakën instaluese të përmendur në pikën 3.4-3.4.1 të kapitullit III të kësaj rregulloreje.

2.10 Të gjitha vendimet në zbatim të kësaj rregulloreje, që refuzojnë ose heqin miratimin e tipit të pajisjes së regjistrimit ose të një modeli flete regjistrimi ose kartës së memories, duhet të specifikojnë në detaje arsyet mbi të cilën ato janë bazuar. Vendimi i komunikohet palës së interesuar, e cila duhet të informohet në të njëjtën kohë për mjetet juridike të ankimimit në dispozicion të saj sipas ligjeve në fuqi, si dhe afateve kohore për ushtrimin e mjeteve të tilla, me qëllim marrjen e masave në kohën e duhur.

2.11 Kartat e memories janë katër llojesh dhe në faqen ballore ato do të përmbajnë fjalët: "Karta e drejtuesit" ose "Karta e kontrollorit", ose "Karta e oficinës", ose "Karta e kompanisë", të shtypura në gjuhën shqipe. Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në bazë të nenit 2 të ligjit nr.10 211, datë 23.12.2009 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.9, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e funksionimit dhe burimet, financimit të sistemit të tahogرافit digjital në Shqipëri", është autoriteti kompetent i lëshimit të kartave të memories.

2.11.1 Shenja dalluese e kartës që lëshohet për Shqipërinë është "AL", në përputhje me ligjin nr.8613, datë 25.5.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën "Për trafikun rrugor" të

8 nëntorit 1968. Kartat e tahogرافit do të shtypen në përputhje me elementet e përcaktuara në apendiksin 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR, ndërsa elementet e tjera që nuk përcaktohen nga ky apendiks, miratohen nga ministri përgjegjës për transportin.

2.11.2 Për kartën e drejtuesit të mjetit shiko kapitullin IV të kësaj rregulloreje, ndërsa për kartën e prodhuesit ose të ofiçinës së autorizuar të tahogرافit shiko kapitullin III të kësaj rregulloreje.

2.12 Karta e zyrtarit të kontrollit lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor vetëm zyrtarëve të kontrollit të autorizuar, pas kërkesës së bërë në këtë institucion nga eprorët e organeve të kontrollit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.207, datë 25.2.2009 dhe organeve të kontrollit në pikat e kalimit të kufirit. Karta e kontrollorit mund të jetë dy llojesh, për një grup personash ose për një person të caktuar. Personat ose grupi i personave që pajisen me kartën e kontrollorit më parë duhet të kenë kryer një kurs kualifikimi dhe të kenë kaluar një provim në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin.

2.12.1 Në rast se karta e një zyrtari të kontrollit është dëmtuar, keqfunksionon, ka humbur ose është vjedhur, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nxjerr jashtë përdorimit kartën e vjetër dhe pajis zyrtarin e kontrollorit me një kartë të re. Karta e kontrollit lëshohet me afat 5 (pesë) vjet.

2.12.2 Nëse zyrtari i kontrollit ose përgjegjësi i një grupi zyrtarësh kontrolli largohet nga puna për arsye të ndryshme, ai është i detyruar para largimit të dorëzojë të gjitha pajisjet personale dhe, së bashku me to edhe kartën personale të kontrollorit. Kartat për zyrtarin ose përgjegjësin e grupit të zyrtarëve të kontrollit lëshohen pa pagesë.

2.13 Karta e kompanisë (ndërmarrjes) lëshohet pas aplikimit të bërë prej saj në Drejtorinë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila përfshihet në zonën juridike ku është regjistruar kompania ose subjekti, i cili kryen veprimtari transporti rrugor për mallra ose udhëtarë. Karta e kompanisë lëshohet me afat pesëvjeçar.

2.13.1 Në rast se karta e një kompanie është dëmtuar, keqfunksionon, ka humbur ose është vjedhur, drejtuesi i veprimtarisë së kompanisë ose pronari ose i autorizuari prej tij dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do të veprojnë njëjloj si me kartën e drejtuesit në kapitullin IV.

2.14 Kërkesat e konstruksionit dhe funksionimit për kartat e tahogرافit jepen në kapitullin IV të apendiksit 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR.

2.15 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor lëshon kartat e memories në përputhje me këtë rregullore dhe udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin. DPSHTRR-ja do të mbajë një regjistër të veçantë për kartat e humbura, të vjedhura ose me defekt, modeli i të cilit miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin. Kartat e memories lëshohen brenda 21 ditëve punë, nga dita e pranimit të kërkesës.

2.16 Tarifa për çdo kartë memorie në varësi të llojit të transaksionit (aplikimi për kartë, rinovimi, zëvendësimi, ndryshimi dhe keqfunksionimi) caktohet në përputhje me nenin 3 dhe 6 të ligjit nr.10 211, datë 23.12.2009. Transaksionet përcaktohen në përputhje me shkronjën "1" të aneksit 1.

2.17 Policia e Shtetit dhe institucionet e ngarkuara me ligj marrin të gjitha masat e nevojshme në parandalimin dhe shpërndarjen e kartave të memories të falsifikuara.

KAPITULLI III INSTALIMI DHE INSPEKTIMI

3. Miratimi i ofiçinës së tahogرافit

3.1 Pajisja regjistruuese instalohet ose riparohet nga teknikët ose nga qendra/qendrat teknike (ofiçina) të tahogرافit, të autorizuar nga ministri përgjegjës për transportin.

3.1.1 Drejtuesi teknik i ofiçinës dhe tekniku i emëruar pajisen me kartë brenda 21 ditëve punë nga aplikimi. Karta e memories dhe PIN (numri i identifikimit personal) nuk dorëzohen në të njëjtën kohë së bashku.

3.1.2 Periudha e vlefshmërisë administrative së kartës së memories për ofiçinat dhe teknikun e autorizuar është 1-(një) vjeçare.

3.1.3 Në rastin kur karta e memories e një drejtuesi teknik ose teknikut të miratuar është dëmtuar, keqfunksionon, ka humbur ose është vjedhur apo kërkohet të zgjatet periudha e vlefshmërisë së saj, ata duhet të sigurojnë një kartë zëvendësuese brenda 21 ditëve punë nga pranimi i kërkesës.

3.1.4 Karta e re lëshohet për të zëvendësuar një të vjetër, si dhe do të mbartë të njëjtin numër informacioni të ofiçinës së autorizuar të tahogرافit, por indeksi do të rritet me një.

3.2 Ofiçina e autorizuar e tahogرافit vendos një shenjë të veçantë mbi vulë, të cilën e fikson dhe, veç kësaj, vendos në pajisjen e regjistrimit të dhënat elektronike të sigurisë, për kryerjen, në veçanti, të kontrolleve autentike. DPSHTRR-ja mban një regjistër për shenjat e veçanta të vulave dhe për të dhënat elektronike të sigurisë të përdorura, si dhe për kartat e memories të lëshuara.

3.3 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor i dërgon Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe organeve homologe të shteteve të tjera listën e teknikëve të miratuar, kartat e lëshuara për ato, një kopje të shenjës së vulave, si dhe një informacion të nevojshëm për sa u përket të dhënave të sigurisë elektronike të përdorur.

3.4 Në përputhje me apendikset 1 ose 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR fiksohet një pllakë instaluese (inspektuese), e cila dëshmon se instalimi i pajisjes regjistruese u vendos në përputhje me apendikset e përmendura. Pllaka instaluese vendoset në një mënyrë të tillë që ajo nuk mund të hiqet pa u shkatërruar.

3.4.1 Ministri përgjegjës për transportin miraton udhëzimin për kërkesat teknike dhe standardet e operimit të ofiçinës së autorizuar të tahogرافit.

3.5 Vula mund të hiqet nga personat e autorizuar nga ofiçina, e miratuar nga ministri përgjegjës për transportin ose në rrethanat e parashikuara në apendikset 1 ose 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR.

4. Informimi dhe pajisjet testuese për QTTM

4.1 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në bazë të një kërkesë ligjore të bërë nga organet e kontrollit ose nga institucionet e ngarkuara me ligj, jep informacione për qëllime hetimi. Ajo nuk jep informacione për qëllime personale.

4.2 Ofiçinat e autorizuar të tahogرافit, në rast konstatimi të pajisjeve të paautorizuara ose ndërhyrjeve, ose prekjeve në pajisjet e regjistrimit, janë të detyruara të raportojnë menjëherë tek organet e kontrollit të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

4.3 Në ofiçinat e autorizuar të tahogرافit vendosen pajisje testuese të miratuara e të përshtatshme për kryerjen me efektivitet të instalimit, inspektimit dhe çmontimit (heqjes) të pajisjes së regjistrimit.

4.4 Instrumentet e testimit të pajisjeve të regjistrimit duhet të kontrollohen për të siguruar konformitetin me standardet e këtyre pajisjeve. Kontrolli i këtyre instrumenteve kryhet çdo gjashtë muaj ose çdo vit sipas kërkesës së prodhuesit. Kontrolli bëhet në çdo kohë të muajit që ajo i përket.

4.5 Testi i konformitetit mund të kryhet nga prodhuesi i pajisjes ose përfaqësuesit e autorizuar prej tyre ose institucionet e akredituara në Shqipëri për instrumentet kalibruese të klasës së duhur. Personat që drejtojnë testin e konfirmimit nuk duhet të kenë lidhje pronësie, punësimi ose familjare me pronarin/pronarët, drejtuesit e emëruar ose persona të tjerë që drejtojnë ofiçinën e autorizuar të tahogرافit.

4.6 Organet e përmendura në pikën 4.5 më sipër lëshojnë certifikatë për çdo pajisje, të cilës i është kryer testi, konfirmimit. Në certifikatë duhet të identifikohet qartë organi dhe emri i inspektorit që ka drejtuar punën dhe, gjithashtu, duhet të tregohet saktësia aktuale e pajisjes. Certifikatat e kalibrimit mbahen në ofiçinën e autorizuar të tahogرافit dhe i paraqitet inspektorëve të DPM-së sa herë kërkohet prej tyre.

5. Ruajtja e dokumentacionit në qendrat teknike të miratuara

5.1 Ofiçinat e autorizuar të tahogرافit duhet të plotësojnë kërkesat për regjistrimet e të gjitha instalimeve, kalibrimi, inspektimeve periodike, punimeve të vogla dhe pllakën instaluese të lëshuar në lidhje me tahogرافin analog ose atij digjital, të cilat duhet të regjistrohen e mbahen me kujdes në qendrën e miratuar për jo më pak se 6 vjet.

5.2 Mënyra e ruajtjes dhe detajet e regjistrimit që duhen të ruhen për të dyja llojet e tahogرافëve jepen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin.

5.2.1 Në rastin e pajisjeve të regjistrimit digjital, çdo ndryshim ose përmirësim nuk duhet të ndryshojë ose fshijë të dhënat e veprimtarisë së drejtuesit të mjetit, të ruajtura (magazinuara) në pajisjen e regjistrimit.

6. Inspektimi i qendrave teknike të miratuara

6.1 Ofiçinat e autorizuar të tahogرافit janë të detyruara të lejojnë inspektorët e ministrit përgjegjës për transportin dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, në bashkëpunim ose veç e veç,

të inspektojnë gjatë kohës që ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Inspektimi do të kryhet të paktën një herë në vit.

7. Tarifat dhe penalitetet

7.1 Tarifat maksimale, të cilat duhet të paguhen nga transportuesit për operacionet, që kryhen nga një oficinë e autorizuar e tahogرافit, si: kontrolli, inspektimi i instalimit, inspektimi periodik, kalibrimi, heqja e pajisjes së regjistrimit etj., miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe Ministrit të Financave. Para miratimit të këtyre tarifave merret mendimi edhe i subjekteve të interesuara. Për të gjitha operacionet e tjera të natyrës komerciale, si: shitja dhe instalimi i pajisjes së regjistrimit, riparime të vogla etj., tarifat janë të lira.

7.3 Si një masë paraprake, autorizimi mund t'i pezullohet një oficine të autorizuar të tahogرافit në rastin e humbjes së besimit.

7.4 Një oficinë e autorizuar të tahogرافit, e cila nuk ka pajisjet e duhura për kryerjen e inspektimeve dhe kalibrimeve, ose nuk ka drejtues veprimtarie dhe, ose teknik të emëruar, për këtë qëllim nuk lejohet të kryejë operacione të tilla.

7.5 Kur një oficine të autorizuar të tahogرافit i hiqet ose pezullohet autorizimi, ose kur drejtuesit teknik ose teknikut i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit në oficinën e autorizuar të tahogرافit, në këtë rast, ai duhet ta kthejë kartën e tij të memories tek organi që e ka lëshuar.

KAPITULLI IV PËRDORIMI I PAJISJES SË REGJISTRIMIT

8. Detyrimet e punëdhënësit dhe drejtuesit dhe kushtet për lëshimin e kartës së drejtuesit

8.1 Para nisjes së udhëtimit, punëdhënësi dhe drejtuesit sigurojnë funksionimin korrekt dhe përdorimin e përshtatshëm të pajisjes së regjistrimit dhe kartës së drejtuesit të mjetit.

8.2 Punëdhënësi pajis me një sasi të mjaftueshme fletësh regjistrimi drejtuesin e mjetit të përshtatur me pajisje regjistrimi në përputhje me apendaksin 1 të aneksit të Marrëveshjes AETR. Punëdhënësi dhe drejtuesi i mjetit përcaktojnë sasinë e fletëve të regjistrimit duke marrë parasysh kohëzgjatjen e periudhës së shërbimit dhe detyrimin e mundshëm në zëvendësimin e fletëve të regjistrimit, të cilat janë dëmtuar, ose që mund të tërhiqen nga një zyrtar i kontrollit gjatë kryerjes së operacioneve të transportit. Punëdhënësi i jep drejtuesit vetëm fletë regjistrimi të një modeli të miratuar, të përshtatshme për përdorimin e tyre në pajisjen e regjistrimit të instaluar në mjet.

8.2.1 Kur mjeti është i përshtatur me pajisje regjistrimi në përputhje me aneksin 1B, punëdhënësi dhe drejtuesit do të garantojnë, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e periudhës së shërbimit, që printimet e përmendura në apendaksin 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR, të kryhen në mënyrë korrekte në rastin e ndonjë inspektimi.

8.3 Ndërmarrjet ruajnë printimet sa herë që janë bërë në përputhje me pikat 9.1 – 9.1.4, sipas rendit kronologjik dhe në një formë të lexueshme qartë për të paktën një vit pas përdorimit të tyre dhe do t'u japë kopje drejtuesve të mjeteve sa herë kërkohet prej tyre.

8.3.1 Ndërmarrja jep kopje të të dhënave të transferuara (shkarkuara) elektronikisht nga kartat e drejtuesit të drejtuesit e interesuar, por, gjithashtu, jep edhe kopje të printuara në letër. Fletët e regjistrimit, printimet dhe transferimet (shkarkimet) elektronike të të dhënave do t'i paraqiten ose dorëzohen me kërkesë cilitdo zyrtari të kontrollit të autorizuar për inspektim.

8.4 Karta e drejtuesit, siç përcaktohet në apendaksin 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR, do të lëshohet me kërkesë të drejtuesit të mjetit nga drejtoria rajonale e DPSHTRR-së, ku drejtuesi i mjetit ka vendqëndrimin e tij normal.

8.4.1 Çdo drejtues, i cili është subjekt i dispozitave të Marrëveshjes AETR dhe, ose rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 dhe vendqëndrimit normal në territorin e tij, duhet të zotërojë kartën e drejtuesit.

8.5 Për qëllime të kësaj rregulloreje, me “vendqëndrim normal” nënkuptojmë vendin ku një person banon zakonisht për të paktën 185 ditë brenda çdo viti kalendarik, për arsye të lidhjeve të tij personale e profesionale, ose në rastin e një personi që nuk ka lidhje profesionale, por ka lidhje personale, të cilat tregojnë marrëdhënie të ngushta ndërmjet këtij personi dhe vendit ku ai banon.

8.5.1 Vendqëndrimi normal i një personi, lidhjet profesionale, të të cilit janë në një vend tjetër nga lidhjet e tij personale, dhe si pasojë, banon në vende të ndryshme që ndodhen në dy ose më shumë palë kontraktuese do të konsiderohet si vendi i lidhjeve të tij personale, me kusht që ky person kthehet atje rregullisht. Kushti i fundit nuk kërkohet kur personi banon në një palë kontraktuese, me qëllim që të

kryejë një detyrë me një kohëzgjatje të caktuar.

8.5.2 Drejtuesit e mjeteve do të provojnë me anën e dokumenteve, siç është letërnjoftimi elektronik ose ndonjë dokument tjetër i barasvlershëm për vendqëndrimin normal të tyre.

8.5.3 Kur DPSHTRR-ja që lëshon kartën e drejtuesit ka dyshime lidhur me vlefshmërinë e dëshmuar për vendqëndrimin normal të bërë në përputhje me pikën 8.5.2 ose për qëllime të disa kontrolleve specifike, ajo lejohet të kërkojë informacione ose të dhëna shtesë.

8.5.4 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si autoritet i lëshimit të kartave të drejtuesve në Shqipëri, duhet të sigurohet për çdo aplikant, para lëshimit të kartës, që ai nuk është zotërues i një karte tjetër të vlefshme si drejtues mjeti.

8.5.5 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor lëshon kartat e drejtuesit, të personalizuar në përputhje me dispozitat e apendiksit 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR.

8.6 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) lëshon kartën e drejtuesit për një afat jo më shumë se 5 (pesë) vjet.

8.6.1 Drejtuesi i mjetit nuk mund të mbajë më shumë se një kartë. Drejtuesi i mjetit është i autorizuar të përdorë vetëm kartën e tij personale. Drejtuesi i mjetit nuk duhet të përdorë kartën e tij, e cila është me defekt ose vlefshmëria e së cilës ka përfunduar.

8.6.2 Kur një kartë e re lëshohet për të zëvendësuar të vjetrën, karta e re do të mbartë të njëjtin numër lëshimi të kartës së drejtuesit, por indeksi do të rritet me një. DPSHTRR-ja do të ruajë regjistrimet e kartave të drejtuesve të lëshuara, të vjedhura, të humbura ose të defektuara për një periudhë të paktën ekuivalente me periudhën e vlefshmërisë administrative të tyre.

8.6.3 Nëse karta e drejtuesit dëmtohet, keqfunksionon ose ka humbur, ose është vjedhur, DPSHTRR-ja do ta pajisë atë me një kartë zëvendësuese brenda 21 ditëve punë nga pranimi i një kërkesë të detajuar për këtë qëllim. Një kartë memorie zëvendësuese do të ruajë afatin e vlefshmërisë së kartës së zëvendësuar. Nëse karta e zëvendësuar ka më pak se 3 (tre) muaj vlefshmëri, DPSHTRR-ja lëshon një kartë të re në vend të kartës zëvendësuese.

8.6.4 Veprimet e aplikimit për kartë të një drejtuesi kryhen në drejtorinë rajonale të DPSHTRR-së ku aplikanti ka vendqëndrimin e tij.

8.6.5 Në rastin e një kërkesë për rinovimin e një karte, data e përfundimit të së cilës është afuar, DPSHTRR-ja e pajis atë me një kartë të re para datës së përfundimit, me kusht që kërkesa të jetë dërguar te ky institucion brenda kufijve të kohës së parashikuar në pikën 9.1.3.

8.7 Karta e drejtuesit i lëshohet vetëm atij drejtuesi që është i përfshirë në dispozitat e Marrëveshjes AETR dhe, ose rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008.

8.8 Karta e drejtuesit është personale. Ajo nuk mund të hiqet ose pezullohet gjatë periudhës së vlefshmërisë zyrtare të saj, vetëm nëse organet e kontrollit konstatojnë se karta është e falsifikuar, ose është përfutur në bazë të deklarimeve dhe, ose dokumenteve të falsifikuara. Nëse organet e kontrollit vendosin të ndërmarrin masa për arsyet e përmendura në këtë pikë, lidhur me pezullimin ose heqjen e kartës së drejtuesit të mjetit të një shteti tjetër, ata duhet ta kthejnë atë menjëherë tek organet kompetente të shtetit, i cili e ka lëshuar kartën së bashku me arsyet e kthimit të saj.

8.9 Kartat e drejtuesit të lëshuara nga organet kompetente të vendeve të tjera, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR, do të njihen nga organi i lëshimit DPSHTRR-ja dhe organet e kontrollit sipas nenit 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

8.9.1 Kur mbajtësi i një karte drejtuesi të vlefshme, e lëshuar nga një shtet tjetër, ka vendqëndrimin e tij normal në Shqipëri, ai mund të kërkojë që karta e tij të ndërrohet me një kartë drejtuesi ekuivalente. Në këtë rast, është përgjegjësia e DPSHTRR-së, e cila kryen ndërrimin, të verifikojë nëse karta e paraqitur është ende faktikisht e vlefshme.

8.9.2 Kur DPSHTRR-ja kryen një ndërrim, ajo duhet të kthejë kartën e vjetër tek organet e lëshimit të shtetit që i përket, duke e shoqëruar me arsyet e kryerjes së këtij veprimi.

8.10 Zëvendësimi ose ndërrimi dhe çdo zëvendësim pasues dhe rinovim i kartës së drejtuesit duhet të regjistrohet nga DPSHTRR-ja.

8.11 Të dhënat, të cilat lidhen me kërkesat për të monitoruar zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes AETR dhe, ose rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 regjistrohen dhe magazinohen nga pajisja e regjistrimit në përputhje me apendiksin 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR, duhet të jenë të vlefshme për të paktën 365 ditë pas datës së regjistrimit të tyre. Inspektorët e DPSHTRR-së dhe organet e caktuara me ligj për zbatimin e dispozitave të

Marrëveshjes AETR dhe, ose rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 kontrollojnë zbatimin për garantimin e kushteve të sigurisë dhe saktësisë së të dhënave.

8.11.1 Në rastin kur pajisja e regjistrimit (njësia e mjetit) hiqet për qëllime riparimi ose rishitje, ato duhet të ruajnë vlerën e tyre në plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 8.11.

9. Dokumentet e kontrollit gjatë udhëtimit

9.1 Drejtuesit e mjeteve nuk lejohet të përdorin fletë regjistrimi ose karta drejtuesi të ndotura ose të dëmtuara. Për këtë arsye, fletët e regjistrimit dhe kartat e drejtuesit duhet të mbrohen mirë.

9.1.1 Në rastin e dëmtimit të fletës së regjistrimit ose kartës së drejtuesit, drejtuesit e mjeteve duhet të bashkëlidhin fletën e regjistrimit ose kartën e drejtuesit të dëmtuar te fleta rezervë ose e përkohshme që përdoret për t'i zëvendësuar ato (fletët e regjistrimit për tahografin analog ose printimet nga njësia e mjetit të tahografit digjital).

9.1.2 Nëse karta e drejtuesit dëmtohet, keqfunksion ose ka humbur, ose është vjedhur, drejtuesi duhet të aplikojë, brenda 7 ditëve kalendarike, për zëvendësimin e saj, në drejtorinë rajonale të DPSHTRR-së, ku ai ka vendqëndrimin e tij. Drejtuesi, i cili është pajisur me kartë të lëshuar nga një shtet tjetër e me vendqëndrim jashtë territorit të Shqipërisë, duhet të marrë masa që të paktën brenda kësaj periudhe të jetë larguar nga Shqipëria në drejtim të shtetit, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR, në të cilin ai ka vendqëndrimin normal të tij.

9.1.3 Në rastin kur një drejtues mjeti aplikon për rinovimin e kartës së tij, ai duhet të aplikojë te drejtoria rajonale e DPSHTRR-së, ku ka vendqëndrimin e tij, brenda 21 ditëve punë para datës së përfundimit të afatit të kartës.

9.1.4 Kur karta e drejtuesit është e dëmtuar, keqfunksionon, ose kur drejtuesi nuk zotëron një të tillë, ai duhet:

a) Të printojë në nisje të udhëtimit të tij, detaje të mjetit që është duke drejtuar dhe duhet të vendosë (regjistrojë) mbi këtë printim:

i) detaje që mundësojnë drejtuesin për t'u identifikuar (emrin, kartën e drejtuesit, numrin e lejes së drejtimit), duke përfshirë nënshkrimin e tij;

ii) periudhat e përmendura në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 9.2.

b) Të printojë në fund të udhëtimit të tij, informacionin në lidhje me periudhat e kohës së regjistruar nga pajisja e regjistrimit, të regjistrojë të gjitha periudhat e punës tjetër, të disponueshmërisë (gatishmërisë) dhe pushimit që ka marrë, që nga printimi që ai ka bërë në fillim të udhëtimit, kur nuk janë të regjistruara nga tahografi, dhe shënon mbi këtë dokument detajet që mundësojnë drejtuesin të identifikohet (emrin, kartën e drejtuesit ose numrin e lejes së drejtimit), duke përfshirë edhe nënshkrimin e tij.

9.1.5 Drejtuesit përdorin fletët e regjistrimit ose kartën e drejtuesit çdo ditë, në të cilën ata drejtojnë duke filluar që nga momenti që marrin në dorëzim mjetin. Fleta e regjistrimit ose karta e drejtuesit nuk hiqet para përfundimit të periudhës së punës ditore, po të mos autorizohet heqja e tyre. Fleta e regjistrimit ose karta e drejtuesit nuk mund të përdoret për të mbuluar një periudhë më të gjatë se, për të cilën, ajo është e destinuar.

9.1.6 Kur një drejtues ndodhet larg mjetit dhe nuk mund të përdor pajisjen e përshtatur (montuar) në mjet, periudhat e kohës së përmendur në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 9.2:

a) do të regjistrohen mbi fletën e regjistrimit, ose manualisht, me anë të regjistrimit automatik ose me mënyra të tjera, qartësisht dhe pa ndotur fletën e regjistrimit, nëse mjeti është i pajisur me pajisje regjistrimi analoge në përputhje me apendiksin 1 të aneksit të Marrëveshjes AETR; ose

b) do të regjistrohen në kartën e regjistrimit duke përdorur lehtësimin e regjistrimit manual të ofruar nga pajisja e regjistrimit, nëse mjeti është i pajisur me pajisje regjistrimi digjitale në përputhje me apendiksin 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR.

9.1.7 Kur në bordin e mjetit ndodhen më shumë se një drejtues, secili drejtues duhet të sigurohet që karta e tij është futur në folenë korrekte të tahografit.

9.1.8 Drejtuesit e mjetit ndryshojnë fletët e regjistrimit, kur në mjet ndodhet më shumë se një drejtues. Për këtë, informacioni i përmendur në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nënparagrafit të dytë të pikës 9.2 regjistrohet në fletën e regjistrimit të drejtuesit, i cili drejton aktualisht.

9.2 Drejtuesit e mjetit duhet:

i) të garantojnë që koha e regjistruar në fletën e regjistrimit përputhet me kohën zyrtare në vendin e regjistrimit të mjetit;

ii) të veprojnë me mekanizmat e ndërrimit (ndryshimit) që u japin mundësi periudhave të kohës që vijojnë për t'u regjistruar më vete e në mënyrë të qartë, si vijon:

a) shenja:  nënkupton kohën e drejtimit;

b) shenja:  nënkupton të gjitha periudhat e tjera të punës (punën tjetër), të përkufizuara sipas shkronjës “dh” të rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008;

c) shenja:  nënkupton të gjitha periudhat e disponueshmërisë, të emërtuara e të përkufizuara sipas shkronjës “t” të rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008;

ç) shenja:  nënkupton ndërprerjet e punës dhe periudhat e pushimit ditor.

9.3 Secili anëtar i ekuipazhit (drejtues) të mjetit është i detyruar të regjistrojë në fletën e tij të regjistrimit informacionin si vijon:

a) në fillim të përdorimit të fletës së regjistrimit – emrin dhe mbiemrin e tij;

b) datën dhe vendin ku përdorimi i fletës së regjistrimit fillon dhe datën dhe vendin e përfundimit;

c) numrin e regjistrimit të secilit mjet për të cilën ai është caktuar, si në nisje të udhëtimit të parë të regjistruar në fletën e regjistrimit dhe më pas, në rastin e ndërrimit të mjetit, gjatë përdorimit të fletës së regjistrimit;

ç) leximin e rrugëmatës:

i) në fillim të udhëtimit të parë të regjistruar në fletën e regjistrimit;

ii) në fund të udhëtimit të fundit të regjistruar në fletën e regjistrimit;

iii) në rastin e ndryshimit të mjetit gjatë një dite pune (leximi në mjetin tek i cili ai ishte caktuar dhe leximi në mjetin tek i cili ai do të caktohet);

d) nëse është e përshtatshme, kohën e ndryshimit të mjetit.

9.3.1 Drejtuesi i mjetit vendos në pajisjen e regjistrimit (tahograf), në përputhje me appendiksin 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR, simbolet e vendeve në të cilat ai fillon dhe përfundon periudhën e punës ditore të tij.

9.3.2 Transportuesi shqiptar, i cili kryen operacione transporti në një shtet tjetër, është i detyruar që të vendosë specifikime gjeografike shtesë, nëse kërkohen nga ky shtet.

9.3.3 Të dhënat e specifikimeve gjeografike, sipas pikës 9.3.2 aktivizohen nga drejtuesi i mjetit, dhe mund të jenë krejtësisht manuale ose automatike nëse pajisja e regjistrimit është e lidhur me sistemin gjurmues (shoqërues) satelitor.

9.4 Pajisja e regjistrimit e përcaktuar në appendiksin 1 të aneksit të Marrëveshjes AETR do të jetë e konstruktuar, në mënyrë të tillë që t'i mundësojë një zyrtari kontrolli të autorizuar, nëse është e nevojshme, pas hapjes së pajisjes, leximin e regjistrimeve në lidhje me nëntë orët para kontrollit, pa deformuar, dëmtuar ose ndotur në mënyrë permanente fletën përkatëse të regjistrimit.

Pajisja duhet të konstruktohet, në mënyrë të tillë që të mundësohet verifikimi i regjistrimeve të kryera pa hapur kapakun.

9.5 a) Kur një drejtues mjeti drejton një mjet të përshtatur me pajisje regjistrimi në përputhje me appendiksin 1 të aneksit të Marrëveshjes AETR, ai duhet të paraqesë, me kërkesë të organeve të kontrollit, dokumentet si vijon:

i) fletët e regjistrimit për ditën aktuale dhe të 28 ditëve të mëparshme, të përdorura nga drejtuesi i mjetit;

ii) kartën e drejtuesit të mjetit nëse ai zotëron një të tillë; dhe

iii) ndonjë regjistrim me dorë dhe printimin bërë gjatë ditës aktuale dhe të 28 ditëve të mëparshme, në lidhje me periudhat e kohës, siç kërkohen në këtë rregullore dhe në rregulloren e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008.

b) Kur një drejtues mjeti drejton një mjet të përshtatur me pajisje regjistrimi në përputhje me appendiksin 1B (tahograf digjital) të aneksit të Marrëveshjes AETR, ai duhet të paraqesë, me kërkesë të organeve të kontrollit, dokumentet si vijon:

i) kartën e drejtuesit të mjetit, të cilën e zotëron;

ii) ndonjë regjistrim me dorë dhe printimin e bërë gjatë ditës aktuale dhe të 28 ditëve të mëparshme në lidhje me periudhat e kohës, siç kërkohen në këtë rregullore dhe në rregulloren e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008; dhe

iii) fletët e regjistrimit që i korrespondojnë një periudhe të njëjtë si te pika “ii” më sipër, gjatë së cilës ai drejton një mjet të përshtatur me pajisje regjistrimi në përputhje me apendiksin 1 të aneksit të Marrëveshjes AETR.

c) Një zyrtar kontrolli i autorizuar ushtron kontroll në përputhje me dispozitat e rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 ose Marrëveshjes AETR me anën e analizave të fletëve të regjistrimit ose të dhënave të shfaqura ose të printuara, të cilat kanë qenë regjistruar nga pajisja e regjistrimit ose nga karta e drejtuesit, ose në mungesë të tyre, nga analizat e çdo dokumenti mbështetës që justifikon mospërputhjen me kushtet e vendosura në pikat 10.3-10.5.3.

9.6 Ndalohet falsifikimi, fshirja ose shkatërrimi i të dhënave të regjistruara a të magazinuara (ruajtura) në pajisjen e regjistrimit ose në kartën e drejtuesit të mjetit, ose printimet nga pajisja e regjistrimit, siç përcaktohet në apendiksin 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR. Gjithashtu, ndalimi vlen edhe për sa i përket manipulimit të pajisjes së regjistrimit ose fletës së regjistrimit, ose kartës së drejtuesit, të cilat mund të rezultojnë me të dhëna dhe, ose informacion të printuar që të jetë i falsifikuar, i fshirë ose i shkatërruar. Në mjet nuk lejohen të vendosen pajisje që sjellin pasojë negative të përmendura në këtë pikë.

10. Përgjegjësitë e drejtuesit të mjetit e të punëdhënësit

10.1 Në rastin e një avarie ose operimi të gabuar të pajisjes së regjistrimit, punëdhënësi duhet ta riparojë atë pranë një qendre teknike të miratuar sa më shpejtë që e lejojnë rrethanat.

10.1.1 Në rastin kur mjeti nuk ka mundësi kthimi brenda një periudhe prej 10 ditësh, e llogaritur nga dita e prishjes (avarisë) ose nga zbulimi i funksionimit me defekt të pajisjes së regjistrimit, riparimi duhet të kryhet gjatë udhëtimit. Në rastin kur drejtuesi i mjetit dhe zotëruesi i licencës së transportit nuk janë i njëjti person, kjo periudhë mund të zgjatet deri në 15 ditë.

10.2 Nëse aktet ligjore të një shteti tjetër përjashtojnë përdorimin e një mjeti sipas pikës 10.1.1, transportuesit shqiptarë janë të detyruar të zbatojnë aktet ligjore të atij shteti ku ata operojnë aktualisht.

10.2.1 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, DPSHTRR-ja dhe shoqatat e transportuesve informojnë transportuesit shqiptarë në lidhje me shtetet që e zbatojnë ose nuk e zbatojnë pikën 10.1.1.

10.3 Kur pajisja e regjistrimit është jashtë përdorimit ose keqfunksionon, drejtuesit do të shënojnë në fletën/fletët e regjistrimit, ose në një fletë të përkohshme, që i bashkëlidhet fletës së regjistrimit ose kartës së drejtuesit, mbi të cilën ai do të regjistrojë të dhënat që i japin mundësi atij për t'u identifikuar (numrin e kartës së drejtuesit dhe, ose emrin dhe, ose numrin e lejes së drejtimit), duke përfshirë firmën e tij, të gjitha informacionet për periudhat e ndryshme të kohës, të cilat nuk janë të regjistruara ose të printuara në mënyrë korrekte nga pajisja e regjistrimit.

10.3.1 Nëse karta e një drejtuesi është dëmtuar, keqfunksionon ose ka humbur, ose është vjedhur, drejtuesi, në fund të udhëtimit të tij, duhet të printojë informacionin në lidhje me periudhat e kohës së regjistruar nga pajisja e regjistrimit dhe të shënojë mbi këtë dokument detaje që i japin mundësi atij të identifikohet (numrin e kartës së drejtuesit dhe, ose emrin dhe, ose numrin e lejes së drejtimit), duke përfshirë edhe firmën e tij.

10.4 Nëse një kartë drejtuesi është dëmtuar apo keqfunksionon, drejtuesi duhet t'ia kthejë atë drejtorisë rajonale të DPSHTRR-së, ku ai ka vendqëndrimin e tij normal.

10.5 Drejtuesi i mjetit deklaron vjedhjen e kartës tek organet kompetente të shtetit ku ka ndodhur ngjarja, në rastin e kryerjes së një transporti ndërkombëtar, ose te Policia e Shtetit, e cila ka në juridiksion zonën ku ka ndodhur ngjarja, në rastin e transportit brenda vendit. Në këtë rast, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të çdo shteti, këto organe pajisin drejtuesin e mjetit me një dokument zyrtar ose mund të njoftojnë organet homologe të shtetit që e ka lëshuar kartën.

10.5.1 Nëse një drejtues humbet kartën e tij, ai duhet ta raportojë me anën e një deklarate zyrtare te drejtoria rajonale e DPSHTRR-së, e cila e ka lëshuar atë, si dhe tek organet kompetente të shtetit, ku ai ka vendqëndrimin e tij normal, nëse këto vende janë të ndryshme.

10.5.2 Një drejtues mjeti mund të vazhdojë të drejtojë pa kartën e tij të drejtuesit për një periudhë maksimale prej 15 deri në 21 ditë kalendarike, nëse kjo është e nevojshme për kthimin e mjetit në qendrën e tij të operimit, nëse ai provon pamundësinë e përgatitjes ose përdorimit të kartës gjatë kësaj periudhe.

10.5.3 Nëse një drejtues, i cili ka vendqëndrimin e tij në Shqipëri, por kartën e ka përfutur nga autoriteti i një shteti tjetër, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR, dhe kur ky drejtues ka kërkuar rinovimin, zëvendësimin ose ndërrimin e kartës, DPSHTRR-ja duhet të informojë autoritetet e lëshimit të kartës së vjetër për arsyt e sakta, për rinovimin, zëvendësimin ose ndërrimin.

10.6 Të gjitha organet e përmendura në këtë rregullore do të bashkëpunojnë me organet homologe të shteteve të tjera në zbatimin e kësaj rregulloreje duke shkëmbyer informacion të rregullt në lidhje me:

a) shkeljet e kryera nga transportuesit që nuk kanë selinë në Shqipëri dhe dënimet e vendosura për shkelje të tilla;

b) dënimet e vendosura nga një shtet tjetër për transportuesit shqiptarë, për shkelje të kryera në atë shtet.

KAPITULLI V DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

11. Periudha e përbashkët e përdorimit të tahogرافëve

11.1 Mjetet që regjistrohen për herë të parë pas datës 1 maj 2006, të cilët përfshihen në fushën e zbatimit të Marrëveshjes AETR dhe, ose rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.09.2008, duhet të jenë pajisur me tahogراف digjital.

11.2 Në shtetet joanëtare të Komunitetit Europian, por palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR, drejtuesit e mjeteve mund të drejtojnë pa kartën e drejtuesit një mjet të përshtatur me tahogراف digjital deri më 16 qershor 2010, por, gjithashtu, është e mundshme të regjistrojnë mjetet e reja me tahogراف analog deri më 16 qershor 2010. Pas datës 16 qershor 2010 kanë mundësi të vazhdojnë të përdorin pa kartën e drejtuesit ato mjete, të cilat ishin regjistruar para kësaj date dhe të përshtatur me tahogراف analog.

11.3 Në rast se kartat e tahogرافit nuk do të jenë lëshuar deri më 16 qershor 2010 në një prej vendeve, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR, mjetet e regjistruara në një prej këtyre vendeve e të pajisura me tahogراف digjital do të aktivizohen e kalibrohen në një oficinë të autorizuar gjatë udhëtimit të parë në përputhje me Marrëveshjen AETR, në vendin e parë, përmes të cilit ato kalojnë, e që mund t'i kryejë këto operacione. Drejtuesit e mjeteve do të mbartin një dëshmi të një ftese me oficinën e parë për të kryer kalibrimin (domethënë një konfirmim me e-mail ose letër).

11.4 Të gjithë drejtuesit e mjeteve që nuk e kanë marrë kartën e drejtuesit deri më 16 qershor 2010 nga autoritetet e vendeve, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR duhet të jenë të afta të provojnë pajtimin me rregullat me anën e printimeve, fletëve të regjistrimit, dëshminë e veprimtarive, në përputhje me procedurën e parashikuar nga dispozitat e Marrëveshjes AETR.

Procedurat për printimet janë si vijon:

a) Në fillim të udhëtimit të tij, drejtuesi do të printojë detajet e mjetit që ai drejton dhe vendos në këtë printim:

i) detajet që lehtësojnë drejtuesin e mjetit për t'u identifikuar (emrin dhe numrin e lejes së drejtimit të tij), që përfshin edhe firmën e tij;

ii) periudhat e përmendura në shkronjat "b", "c" dhe "ç" të nënparagrafit të dytë të pikës 9.2:

1. Të gjitha periudhat e tjera të punës.

2. Periudhat e tjera të disponueshmërisë, emrin, kohën pritëse, domethënë periudhat e emërtuara e të përkufizuara në shkronjën "t" të rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008.

3. Ndërprerjet e periudhat e pushimit ditor.

b) Në fund të udhëtimit, drejtuesi i mjetit do të printojë informacionin në lidhje me periudhat e kohës së regjistruar nga pajisja e regjistrimit, regjistrimin e periudhave të punës tjetër, disponueshmërisë, pushimit të ndërmarrë që nga printimi i bërë në fillim të udhëtimit, ku nuk regjistrohet nga tahogرافi, dhe shënimi në këtë dokument i detajeve që lehtësojnë drejtuesin të identifikohet (emri dhe numri i lejes së drejtimit të tij), që përfshin firmën.

11.5 Drejtuesit e mjeteve të përfshira në rregulloren e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 dhe, të cilët përdorin mjete të regjistruara për herë të parë pas datës 16 qershor 2010, duhet të pajisen me kartën e drejtuesit deri më 31 dhjetor 2010.

11.6 Organet e kontrollit në rrugë do të lejojnë drejtimin e mjeteve nga drejtues që ende nuk janë pajisur me kartën e tyre, kur ata drejtojnë një mjet të përshtatur me tahogراف digjital, vetëm kur operojnë

në përputhje me pikat 11.3 dhe 11.4. Pikat 11.3 dhe 11.4 do të shtrinë efektin e tyre deri më 31 dhjetor 2010, pas kësaj periudhe ato nuk do të kenë më efekt.

11.7 Pikat 11.3 dhe 11.4 më sipër nuk zbatohen për drejtuesit e mjeteve të regjistruar në një vend ku përdorimi i kartës është i detyrueshëm. Megjithatë, drejtuesi duhet të paraqesë printimet sa herë që kërkohen prej zyrtarit të kontrollit. Printimet e bëra do të plotësohen me shënime që u japin mundësi drejtuesve për t'u identifikuar (emrin dhe numrin e lejes së drejtimit), duke përfshirë nënshkrimin e tij.

11.8 Të gjithë drejtuesit e mjeteve të vendeve, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR, pas datës 31 dhjetor 2010 duhet të jenë të pajisur me kartën e drejtuesit dhe ta përdorin atë nëse drejtojnë mjete me tahograf digjital, pavarësisht datës së regjistrimit të mjetit.

11.9 Në rastin kur tahografi ekzistues, analog i një mjeti të regjistruar për herë të parë para datës 1 maj 2006, del jashtë përdorimit, ai zëvendësohet vetëm me tahograf digjital.

ANEKSI 1

Për qëllime të kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet që vijojnë:

a) "AETR" nënkupton "Marrëveshjen europiane në lidhje me punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor dhe protokollin e nënshkrimit e amendamentin e 4 të saj", ratifikuar me ligjin nr.9514, datë 18.4.2006.

b) "Apendiksi 1 i Marrëveshjes AETR" nënkupton kërkesat për konstruksionin, testimin, instalimin dhe inspektimin e pajisjes së regjistrimit analoge automatike ose gjysmautomatike e përdorur në transportin rrugor.

c) "Apendiksi 1B i Marrëveshjes AETR" nënkupton kërkesat për konstruksionin, testimin, instalimin dhe inspektimin e pajisjen digjitale të regjistrimit e përdorur në transportin rrugor.

ç) "Ditë kalendarike" nënkupton një ditë që kufizohet nga ora 00:00 deri në orën 24:00.

d) "Drejtues teknik" nënkupton një drejtues i një ofiçine tahografi, e miratuar, i caktuar nga mbajtësi i miratimit si përgjegjës për operacionet e ofiçinës.

dh) "Jashtë qëllimit" nënkupton kur përdorimi i pajisjes së regjistrimit nuk kërkohet në përputhje me dispozitat e vendimin të Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 dhe, ose Marrëveshjen AETR;

e) "Karta e drejtuesit të mjetit" nënkupton një kartë tahografi e lëshuar nga autoritetet e një pale kontraktuese të një drejtues mjeti të veçantë. Karta e drejtuesit identifikon drejtuesin dhe lejon për magazinimin e të dhënave të veprimtarisë së drejtuesit të mjetit.

ë) "Karta e kompanisë" nënkupton një kartë tahografi nga autoritetet e një pale kontraktuese të pronari ose zotëruesi i mjeteve të përshtatura me pajisjet e regjistrimit. Karta e kompanisë identifikon kompaninë dhe lejon për paraqitjen, transferimin elektronik dhe printimin e të dhënave të magazinuar në pajisjen e regjistrimit, të cilat ishin kyçur nga kjo kompani.

f) "Karta e kontrollit" nënkupton një kartë tahografi e lëshuar nga autoritetet e një pale kontraktuese tek organet e kontrollit. Karta e kontrollit identifikon organin e kontrollit dhe i mundëson zyrtarit të kontrollit dhe e lejon për marrjen e të dhënave të magazinuar në memorien e të dhënave ose në kartën e drejtuesit të mjetit për lexim, printim dhe, ose transferim elektronik.

g) "Karta e ofiçinës" nënkupton një kartë tahografi e lëshuar nga autoritetet e një pale kontraktuese për prodhuesin e pajisjes së regjistrimit, teknikun, prodhuesin e mjetit ose ofiçinën e tahografit, e miratuar nga kjo palë kontraktuese. Karta e ofiçinës identifikon mbajtësin e kartës dhe lejon testimin, kalibrimin dhe, ose transferimin elektronik nga pajisja e regjistrimit.

gj) "Miratimi i tipit" nënkupton procesin e certifikimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga një organ i caktuar nga një shtet, palë kontraktuese në Marrëveshjen AETR, që pajisja e regjistrimit (ose komponentët e saj) ose karta e tahografit sipas investigimit plotësojnë kërkesat e apendiksit 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR.

i) "Njësia e mjetit (NjM)" nënkupton pajisjen e regjistrimit me përjashtim të sensorit të lëvizjes dhe kabllon që lidh sensorin e lëvizjes. Njësia e mjetit mund ose të jetë një njësi unike ose e përbërë nga disa njësi në mjet, me kusht që ajo të përputhet me kërkesat e sigurisë së apendiksit 1B të aneksit të Marrëveshjes AETR.

j) "Ofiçina e tahografit, e miratuar" nënkupton një person, entitet ose organizatë e miratuar, e cila drejton instalimin, aktivizimin, inspektimin, kontrollin, kalibrimin dhe plumbosjen e pajisjes së regjistrimit, fiksimit e pllakave kalibruese dhe lëshimin e certifikatës në përputhje me kërkesat e rregullores 3821/85 EEC dhe, ose AETR e kërkesat e legjislacionit të Shqipërisë.

k) “Pajisje regjistrimi” nënkupton pajisjen e destinuar për instalimin në mjetet rrugore për të treguar, regjistruar dhe magazinuar (ruajtur) automatikisht dhe gjysmautomatikisht detaje të lëvizjes së këtyre mjeteve dhe disa nga periudhat e punës së drejtuesve të tyre.

l) “Llojet e transaksionit për çdo kartë” nënkupton veprimet si vijon:

- “aplikimi për kartë” mbulon lëshimin e një karte dhe kartat shtesë në vazhdimësi të kompanisë, për ato kompani që kanë nevojë për karta shtesë;

- “rinovimi” mbulon lëshimin e një karte të re për shfuqizimin e një karte ekzistuese. Kartat e drejtuesit dhe kompanisë do të rinovohen çdo 5 vjet dhe kartat e kontrollit çdo 2 vjet;

- “ndryshimi” lëshimi i një karte të re që mbart të njëjtën datë shfuqizimi të kartës, të cilën ajo zëvendëson, nëse hollësitë personale për kartën ekzistuese ndryshojnë;

- “zëvendësimi” të zëvendësojë një kartë që ka humbur ose është vjedhur;

- “keqfunksionimi” të zëvendësojë një kartë me të meta.

ll) “Pajisje regjistruese” nënkupton pajisjen ose pajisjen e përgjithshme të destinuar për t’u instaluar në mjetet rrugore për të treguar dhe regjistruar në mënyrë automatike ose gjysmautomatike, detaje të lëvizjes së këtyre mjeteve dhe disa periudhave të punës së drejtuesve të tyre.

VENDIM

Nr.1073, datë 3.11.2010

PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2011-2013, TË RISHIKUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 28 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2011 - 2013, të rishikuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.1074, datë 3.11.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.588, DATË 28.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK, TË TREGUESVE MAKROEKONOMIKË E FISKALË TË RISHIKUAR DHE TË TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2011-2013”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.588, datë 28.7.2010 të Këshillit të Ministrave, lidhjet nr.1, 2, 2/1 e 3, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me lidhjet nr.1, 2, 2/1 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
										Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	3.1	3.1	3.1	3.1	3.1	3.2	3.2	3.2	3.2	3.2	3.2	3.2
Inflacioni (mesatar)	%	5.2	2.4	2.9	2.4	2.4	2.9	3.4	2.2	3.0	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	2.4	5.4	2.4	2.6	2.7	3.6	4.4	2.0	3.0	3.0	3.0	3.0
Rritja reale e PBB	%	4.2	5.8	5.7	5.7	5.4	5.9	7.7	3.3	4.1	5.5	6.1	6.2
Rritja nominale e PBB	%	6.7	11.5	8.2	8.5	8.3	9.7	12.4	5.3	7.2	8.7	9.3	9.4
PBB	Lek miliardë	622.7	694.1	751.0	814.8	882.2	967.7	1,088.1	1,145.3	1,228.1	1,335.1	1,459.7	1,597.5
PBB për banor	Lek mijë	201.9	223.7	240.7	259.9	280.1	306.0	343.5	359.6	384.4	416.5	453.7	494.8
Norma e papunësisë	%	15.8	15.0	14.4	14.1	13.8	13.2	12.7	13.8	13.6	12.5	11.2	9.8

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT

Lidhja nr. 2

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR

Ne milion leke

Nr.	E M E R T I M I	2008	2009	2010	2011	2012	2013
				Buxheti i Rishikuar	Draft Buxheti	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	291.238	299.597	333.658	362.222	394.956	434.240
I.	Ndihmat	4.228	4.430	6.310	8.422	6.948	6.925
II.	Te ardhura tatimore	264.421	270.830	299.083	332.777	369.005	409.029
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	205.292	208.870	229.709	256.138	284.015	315.001
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	107.094	110.062	121.984	136.242	151.456	168.640
2	Tatimi mbi Fitimin	18.108	17.149	17.235	19.252	21.433	23.833
3	Akcizat	32.610	33.504	38.709	43.659	48.630	54.102
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	24.498	26.820	28.698	32.084	35.677	39.602
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	14.423	13.405	15.550	17.143	18.881	20.728
6	Taksa Doganore	8.660	7.929	7.533	7.759	7.937	8.096
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	11.307	12.148	15.479	17.300	19.894	22.879
1	Taksa lokale	7.137	8.153	10.350	11.298	12.885	14.966
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	1.586	1.509	1.895	2.113	2.345	2.556
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	2.584	2.486	3.234	3.889	4.664	5.356
II.3	Te ardhura nga fondet speciale	47.822	49.812	53.896	59.340	65.096	71.149
1	Sigurimi Shqeror	42.547	44.344	46.482	51.210	56.178	61.402
2	Sigurimi Shendetsor	5.275	5.467	6.014	6.730	7.518	8.347
3	Te ardhurat per kompensimin ne vleren te pronareve			1.400	1.400	1.400	1.400
III.	Te ardhura jotatimore	22.588	24.338	28.264	21.023	19.104	18.285
1	Trans.Fitimi nga Banka e Shqiperise	5.700	6.241	6.000	6.200	6.300	6.400
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	8.919	9.860	13.264	10.323	8.704	7.785
3	Dividenti	6.402	3.584	100	500	100	100
4	Te tjera nga ISSH		4.182	3.000	3.000	3.000	3.000
5	Te tjera	1.567	471	5.900	1.000	1.000	1.000
	TOTALI I SHPENZIMEVE	351.491	379.602	371.767	409.035	432.289	465.007
I.	Shpenzime Korrente	250.298	283.637	300.960	320.917	342.310	366.883
I.1	Personeli	66.621	62.359	66.867	69.420	72.644	76.090
1	Paga	55.983	53.272	56.086	67.925	71.144	74.589
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	10.637	9.087	8.414			
3	Polibikat e reja pagash			2.366	1.495	1.500	1.500
I.2	Interesat	31.307	36.301	43.526	47.838	53.021	55.304
1	Te brendshme	28.386	31.408	36.200	39.700	44.400	46.700
2	Te Huaja	2.921	4.893	7.326	8.138	8.621	8.604
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	28.788	31.797	30.737	32.575	33.466	36.241
I.4	Subvencionet	2.555	2.004	1.835	1.749	1.200	1.100
I.5	Mbeshtetje per Energjine	0	0	0	0	0	0
I.5	Shpenzime per Sig Sociale dhe transferime te tjera	76.199	98.463	108.768	116.805	123.624	134.057
1	Sigurime Shoqerore	65.823	73.744	79.419	85.300	90.940	97.214
2	Politika te reja pensionesh	0	22.980	2.000	2.038	2.100	2.300
3	Sigurime Shendetsore	10.376	1.739	25.649	27.467	28.384	31.143
4	Shpenzime per Kompensimin ne Vleren te Pronareve	0	0	1.700	2.000	2.200	3.400
I.6	Buxheti lokal	27.079	33.583	29.686	31.772	36.355	40.391
1	Buxheti lokal (Grant)	15.772	21.435	14.207	14.472	16.460	17.512
2	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	11.307	12.148	15.479	17.300	19.894	22.879
I.7	Shpenzime te tjera	17.750	19.129	19.542	20.758	22.000	23.700
1	Pagesa e papunesise	825	868	950	1.100	1.000	1.100
2	Ndihma Ekonomike	15.925	16.060	16.542	17.158	18.000	19.000
3	Kompensim per te permdjekurit politike	1.000	2.200	1.400	2.000	2.500	3.000
4	Kompensim per energjin elektrike	0	0	650	500	500	600
5	Subvencion te Pastrehet	0	0	0			
	Kompensim ne vleren e pronareve						
II.	Fondi Rezerve	0	0	5.230	6.365	9.661	13.039
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0	0	2.500	1.500	1.500	2.500
2	Fondi Kontigjence per ruajtjen e deficitit	0	0	2.730	4.865	8.161	10.539
III.	Shpenzime Kapitale	93.783	95.881	66.777	81.743	80.318	85.085
1	Financimi Brendshem	50.046	75.600	43.016	43.176	41.376	47.933
2	Transferta Kapitale per OST	150					
3	Financimi Huaj	43.587	20.281	20.761	38.567	38.942	37.152
	Fondi i Ngrire per Financim te Huaj			3.000			
IV	Transferta te ndryshme	7.411	85	-1.200	0	0	0
	DEFICITI	-60.253	-80.005	-38.109	-46.813	-37.333	-30.768
	FINANCIMI DEFICITIT	60.254	80.005	38.109	46.813	37.333	30.768
	Brendshem	24.417	69.824	29.318	27.368	43.016	12.474
	Te ardhura nga Privatizimi	5.538	27.650	300	300	300	300
	Hua-marje e brendeshme	18.012	43.339	29.018	27.068	42.716	12.174
	Te tjera	866	-1.165				
	i Huaj	35.837	10.182	8.791	19.445	-5.683	18.294
	Hua afatgjate(e marre)	39.794	15.375	17.451	30.296	32.094	30.227
	Ndryshimi i gjendjes se arkës	292	567	0			
	Ripagesat	-4.248	-5.760	-8.660	-10.851	-37.777	-11.933
	MEMO:						
	Borxhi Publik Total	595.780	682.389	730.698	787.711	824.744	862.640
	Borxhi publik i buxhetit qendror	595.780	682.389	720.198	766.711	803.744	834.212
	i Brendshem	400.456	417.776	446.794	473.862	516.578	528.752
	i Huaj	195.324	264.613	273.404	292.849	287.166	305.460
	Borxhi publik hipotetik jashte treguesve fiskal	0	0	10.500	21.000	21.000	28.428
	PBB nominal	1.088.132	1.144.340	1.228.068	1.333.104	1.439.723	1.497.482

Burimi: Ministria e Financave

Lidhja nr. 2/1

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR

Ne % te PBB

Nr.	E M E R T I M I	2008	2009	2010	2011	2012	2013
				Buxheti i Rishikuar	Draft Buxheti	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	26,8	26,2	27,2	27,1	27,1	27,2
I.	Ndihmat	0,4	0,4	0,5	0,6	0,5	0,4
II.	Te ardhura tatimore	24,3	23,6	24,4	24,9	25,3	25,6
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	18,9	18,2	18,7	19,2	19,5	19,7
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	9,8	9,6	9,9	10,2	10,4	10,6
2	Tatimi mbi Fitimin	1,7	1,5	1,4	1,4	1,5	1,5
3	Akcizat	3,0	2,9	3,2	3,3	3,3	3,4
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	2,3	2,3	2,3	2,4	2,4	2,5
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1,3	1,2	1,3	1,3	1,3	1,3
6	Taksa Doganore	0,8	0,7	0,6	0,6	0,5	0,5
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	1,0	1,1	1,3	1,3	1,4	1,4
II.3	Te ardhura nga fondet speciale	4,4	4,3	4,4	4,4	4,5	4,5
1	Sigurimi Shoqeror	3,9	3,9	3,8	3,8	3,8	3,8
2	Sigurimi Shendetosor	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5
3	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	0,0	0,0	0,1	0,1	0,1	0,1
III.	Te ardhura jotatimore	2,1	2,1	2,3	1,6	1,3	1,1
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0,5	0,5	0,5	0,5	0,4	0,4
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	0,8	0,9	1,1	0,8	0,6	0,5
3	Dividenti	0,6	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0
4	Te tjera nga ISSH	0,0	0,4	0,2	0,2	0,2	0,2
5	Te tjera	0,1	0,0	0,5	0,1	0,1	0,1
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,3	33,1	30,3	30,6	29,6	29,1
I.	Shpenzime Korrente	23,0	24,8	24,5	24,0	23,5	23,0
I.1	Personeli	6,1	5,4	5,4	5,2	5,0	4,8
1	Paga	5,1	4,7	4,6	5,1	4,9	4,7
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	1,0	0,8	0,7	0,0	0,0	0,0
3	Politikat e reja pagash	0,0	0,0	0,2	0,1	0,1	0,1
I.2	Interesat	2,9	3,2	3,5	3,6	3,6	3,5
1	Te brendshme	2,6	2,7	2,9	3,0	3,0	2,9
2	Te Huaja	0,3	0,4	0,6	0,6	0,6	0,5
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	2,6	2,8	2,5	2,4	2,3	2,3
I.4	Subvencionet	0,2	0,2	0,1	0,1	0,1	0,1
I.5	Mbeshetet per Energjine	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera	7,0	8,6	8,9	8,7	8,5	8,4
1	Sigurime Shoqerore	6,0	6,4	6,5	6,4	6,2	6,1
2	Politika te reja pensionesh	0,0	2,0	0,2	0,2	0,1	0,1
3	Sigurime Shendetosore	1,0	0,2	2,1	2,1	1,9	1,9
4	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	0,0	0,0	0,1	0,1	0,2	0,2
I.6	Buxheti lokal	2,5	2,9	2,4	2,4	2,5	2,5
1	Buxheti lokal (Granti)	1,4	1,9	1,2	1,1	1,1	1,1
2	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	1,0	1,1	1,3	1,3	1,4	1,4
I.7	Shpenzime te tjera	1,6	1,7	1,6	1,6	1,5	1,5
1	Pagesa e papunesise	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1
2	Ndihma Ekonomike	1,5	1,4	1,3	1,3	1,2	1,2
3	Kompensim per te perndjekurit politike	0,1	0,2	0,1	0,1	0,2	0,2
4	Kompensim per energjin elektrike	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0
II.	Fondi Rezerve	0,0	0,0	0,4	0,5	0,7	0,8
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0,0	0,0	0,2	0,1	0,1	0,2
2	Fond Kontigjence per ruajtjen e deficitit	0,0	0,0	0,2	0,4	0,6	0,7
III.	Shpenzime Kapitale	8,6	8,4	5,4	6,1	5,5	5,3
1	Financimi Brendshem	4,6	6,6	3,5	3,2	2,8	3,0
3	Financimi Huaj	4,0	1,8	1,7	2,9	2,7	2,3
	Fondi i Ngrire per Financim te Huaj	0,0	0,0	0,2	0,0	0,0	0,0
IV	Transferta te ndryshme	0,7	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,0
	DEFICITI	-5,5	-7,0	-3,1	-3,5	-2,6	-1,9
	FINANCIMI DEFICITIT	5,5	7,0	3,1	3,5	2,6	1,9
	Brendshem	2,2	6,1	2,4	2,0	2,9	0,8
	Te ardhura nga Privatizimi	0,5	2,4	0,0	0,0	0,0	0,0
	Hua-marje e brendeshme	1,7	3,8	2,4	2,0	2,9	0,8
	Te tjera	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0
	I Huaj	3,3	0,9	0,7	1,5	-0,4	1,1
	Hua afatgjate(e marre)	3,7	1,3	1,4	2,3	2,2	1,9
	Ndryshimi i gjendjes se arkës	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
	Ripagesat	-0,4	-0,5	-0,7	-0,8	-2,6	-0,7
MEMO:							
	Borxhi Publik Total	54,8	59,6	59,5	59,0	56,5	54,0

Lidhja nr. 3

Tavanet e Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, ne milion Leke																		
Emertimi i Institucionit Buxhetor	viti 2011						viti 2012						viti 2013					
	600+601	602-606	230-231		Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali	600-601	602-606	230-232		transferime per Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali	600-601	602-606	230-232		Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali
	Paga+Sig.shoq.	Te tjera Korente	investime/ brendshme	investime/ huaja			pagat	tjera korente	investime/ brendshme	investime/ huaja			pagat	tjera korente	investime/ brendshme	investime/ huaja		
1 Presidencia	95	58	15			168	106	55	70			231	111	57	70			239
2 Kuvendi	490	278	554			1,322	626	217	142			985	656	228	142			1,026
3 Keshilli Ministrave	175	150	15			340	188	115	50			353	197	120	50			367
4 Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	772	327	514	1,000		2,614	799	285	608	1,000		2,692	837	300	608	1,000		2,745
5 Ministria e Bujqesise, Ushqim. dhe Mbrojt. se Konsum.	1,723	2,284	1,255	1,600		6,862	1,826	2,764	2,389	900		7,879	1,914	3,113	4,589	500		10,116
6 Ministria e Puneve Publike, Transport dhe Telekomunik.	1,120	3,312	24,585	19,623		48,640	1,182	2,838	6,602	26,339		36,962	1,239	2,241	11,468	26,878		41,825
10 Ministria e Financave	3,260	1,100	800	651	1,750	7,561	3,432	1,088	602		1,800	6,922	3,597	1,142	602		1,850	7,192
11 Ministria e Arsimit dhe Shkences	27,200	8,284	2,710	2,200		40,394	28,762	8,943	6,500	2,000		46,205	30,002	11,248	7,500	2,000		50,751
12 Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	910	616	1,227	448		3,201	942	634	600			2,176	987	666	600			2,253
13 Ministria e Shendetesise	2,430	1,740	2,634	2,077	20,737	29,618	2,599	1,879	5,134	1,000	20,866	31,478	2,889	2,048	6,301	1,000	22,796	35,035
14 Ministria e Drejtesise	3,986	1,043	540	300	600	6,469	4,221	1,061	675		800	6,757	4,423	1,114	1,575	300	2,000	9,413
15 Ministria e Puneve te Jashtme	280	1,878	114			2,272	274	1,779	179	300		2,532	287	1,868	179			2,335
16 Ministria e Brendshme	11,606	3,164	956	549		16,276	12,108	3,259	1,000	1,405		17,773	12,694	3,422	1,533	1,405		19,055
17 Ministria e Mbrojtjes	7,200	6,416	3,325	250	4,440	21,631	7,156	5,722	7,799	1,000	3,000	24,677	7,499	5,514	10,084	1,000	3,000	27,097
18 Sherbimi Informativ Shtetor	960	285	78			1,323	1,019	273	123			1,414	1,067	287	123			1,477
19 Drejtoria e Radio Televizionit	0	375	65			440	0	386	100			486	0	406	100			506
20 Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	128	38	9			175	128	39	19			186	134	41	19			194
22 Akademia e Shkences	34	50	1			85	35	46	2			83	36	49	2			87
24 Kontrolli Larte i Shtetit	217	49	10			276	230	51	10			291	211	53	10			304
25 Ministria e Punes, Cesht. Sociale dhe Shanseve te Bara.	1,105	21,226	200		27,900	50,431	1,149	22,520	202		29,962	53,833	1,204	24,324	202		30,962	56,692
28 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	891	253	402	320		1,866	914	261	400	320		1,894	957	274	400	320		1,951
29 Prokuroria e Pergjithshme	963	238	134	400		1,735	981	225	168			1,373	1,028	236	168			1,432
29 Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjygesor	1,335	250	185			1,770	1,395	194	242			1,831	1,462	204	242			1,908
30 Gjykata Kushtetuese	73	23	5			101	79	22	5			105	83	23	5			110
31 Agjensia Telegrafike Shqiptare	74	17	3			93	79	17	5			101	83	18	5			106
40 Partite Politike	0	215	0			215	0	225	0			225	0	236	0			236
50 Instituti Statistikes	200	170	286	761		1,417	205	194	10			409	215	204	10			429
55 Shkolla e Magjistratures	25	28	2			55	24	29	2			55	25	30	2			58
56 Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1,830	8,000		9,830	0	0	655	4,679		5,334	0	0	655	2,750		3,405
57 Qendra Kombetare e Kinematografise	9	109	2			119	9	112	2			124	10	118	2			130
63 Keshilli i Larte i Drejtesise	56	27	4			87	50	22	4			76	53	23	4			79
66 Avokati i Popullit	68	14	3			85	71	15	6			92	75	16	6			96
67 Komisioni i Sherbimit Civil	32	9	2			42	36	9	2			47	37	10	2			49
73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	75	623	3			701	82	23	3			108	86	623	3			712
76 Inspektoriat i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	62	21	4			86	65	22	4			91	68	23	4			95
77 Autoriteti i Konkurences	47	10	4	100		161	50	10	5			65	53	10	5			68
78 Ministria e Integrimit	84	59	35	167		345	90	84	16			191	95	89	16			199
82 Keshilli Kombetar Kontabilitetit	7	6	1			15	7	7	2			16	8	7	2			17
86 Avokati i Prokurimeve	20	5	0			25	21	5	2			28	22	5	2			29
87 Institucione te tjera Qeveritare	156	235	647	120		1,158	137	240	157			533	143	252	157			552
88 Mbeshtetje per shoqerine civile	13	80	2			95	13	83	2			97	13	87	3			103
89 Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale	32	10	3			45	34	11	7			51	35	11	7			53
91 Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	24	6	13			42	21	6	12			39	22	6	12			40

URDHËR
Nr.184, datë 20.12.2010

PËR PROCEDURËN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të neneve 142, 143 dhe 144 të ligjit nr.10 040 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”,

URDHËROJ:

1. Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative në Aviacionin Civil (KSHKA) të përbëhet nga 5 veta dhe përbërja e tij të krijohet me urdhër të brendshëm të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, i cili është edhe kryetari i KSHKA-së.

2. Drejtori ekzekutiv, me miratimin e ministrit, vendos ngritjen e KSHKA-së, kur ka shkaqe të arsyeshme, sipas një ose disa prej parashikimeve të nenit 142 të Kodit Ajror.

3. Drejtori ekzekutiv mund të urdhërojë ngritjen e KSHKA-së nisur nga çdo informacion tjetër marrë formalisht ose jo nga çdo subjekt që ka një interes të ligjshëm me Aviacionin Civil.

4. Konsiderohet shkak i arsyeshëm sinjalizimi nga një inspektor/nëpunës i Autoritetit të Aviacionit Civil me anë të një raport inspektimi/raport auditivi, që evidenton qartë mospërputhjen me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Në përbërje të KSHKA-së duhet të jenë persona që, për shkak të detyrave funksionale, gëzojnë aftësinë e nevojshme për të shqyrtuar kundërvajtjet administrative, në kuptim të Kodit Ajror.

6. KSHKA-ja shqyrton kundërvajtjen administrative brenda 10 ditëve që nga momenti i krijimit të tij.

7. Subjekti i gjobitur ka të drejtë të bëjë ankim për vendimin e marrë nga KSHKA-ja te ministri brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi.

8. Ministri shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës.

9. Me kalimin e 30 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës te ministri, ankuesi i drejtohet gjykatës. Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të komisionit.

10. KSHKA-ja njihet me çështjen objekt shqyrtimi, si dhe me çdo dokument eventual që disponohet, të tillë si raport auditimi/inspektimi/informacioni formal ose jo.

11. Nëse çmohet e arsyeshme, bëhen investigime të mëtejshme për të pasur një informacion të plotë e të hollësishëm mbi çështjen.

12. I gjithë procesi i shqyrtimit pasqyrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.

13. KSHKA-ja merr vendim me shumicën e anëtarëve të tij. KSHKA-ja mund të vendosë:

a) gjobë, duke specifikuar masën e saj;

b) pushimin e procedimit nëse:

i) shkelja nuk ekziston ose provohet se ekziston;

ii) shkelja nuk parashikohet nga ligji si kundërvajtje administrative.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit, drejtori ekzekutiv paraqet një raport të hollësishëm, së bashku me vendimin e KSHKA-së për Ministrin.

14. Vendimi i KSHKA-së përmban:

a) identitetin e subjektit të gjobitur;

b) parashtrim të përmbledhur të fakteve, duke treguar referencën ligjore përkatëse, e cila përcakton shkeljen;

c) masën e gjobës;

d) mënyrën e pagesës së saj.

15. Vendimi i KSHKA-së nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative dhe i dërgohet për njoftim subjektit.

16. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.
17. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Holldashi

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 24.1.2011

Doli nga shtypi më 26.1.2011

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë